



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:098254

Datë: 15.04.2022

Numri i dokumentit: 02921316

P.nr.128/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Mentor Hajraj dhe Branka Semenov, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.S për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, të akuzuarve J.S dhe A.J për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarit J.S për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, të akuzuarve J.S dhe A.J për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarve N.K dhe I.Z për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.303/2014 e dt.30.07.2015, të cilën Aktakuzë e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Natasha Radoviq, kanë prezantuar të akuzuari J.S, A.J, N.K dhe I.Z dhe mbrojtësi i të akuzuarit N.K sipas autorizimit av.Abit Asllani nga Prishtina, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor e cila ka qenë e hapur dhe publike në respektim të masave anti Covid-19, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së, me dt.18.03.2022, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa është përpiluar me dt.15.04.2022 ky:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- 1. J.S**, nga i ati I., e ëma M., e vajzërisë G., i lindur më ..., në ..., me vendbanim në ... – ..., ..., me nr. të pasaportës ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës dhe Britanisë së Madhe, me profesion ekonomist biznesmen, Drejtor i Kompanisë C. Shpk, Vushtrri, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer Fakultetin e Biznesit dhe Financave në Londër – Britani të Madhe, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, nën masën e paraburgimit nga dt.26.12.2014 e deri me datë 13.07.2017 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga datë 13.07.2017 deri me datë 26.08.2017.
- 2. A.J**, nga i ati B., e ëma M., e vajzërisë G., i lindur më ..., në P..., ku edhe jeton në lagjën ... nr...., me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin Juridik, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,
- 3. N.K**, nga i ati R., e ëma A., e vajzërisë K., i lindur më ..., në fsh.... Komuna e ..., me vendbanim në rrugën "...", p.n. Komuna e ..., me numer personal ..., Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin Teknik, me profesion Inxhinier i Ndërtimtarisë, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.
- 4. I.Z**, nga i ati Q., e ëma R., e vajzërisë D..., i lindur më ..., në fsh.... Komuna e ..., me vendbanim në fsh.... Komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i

Republikës së Kosovës, ka të kryer Fakultetin Juridik, Jurist i Diplomuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, prind i një fëmiu.

I. I akuzuari J.S;

Në mbështetje të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, si nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës, Gjykata merr këtë vendim:

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE: Si drejtor i Kompanisë C. Shpk me seli në Vushtrri dhe C. DMCC (me seli në Dubai) ka mashtruar dhe i ka shkaktuar dëm kreditorit S. B PLC me seli në Londër Britani të Madhe, ashtu që me datë 25.08.2011, ka lidh marrëveshjen e huasë/kredisë me kreditorin në vlerë prej 9.457.090€, (nëntë milion e katërqindpesëdhjetë shtatë mijë euro) me datë 06 Shtator 2011, ka lidhur marrëveshjen RCF për lehtësimin në vlerë deri në 3.000.000,00 Euro (tre milion euro), më datë 04 Nëntor 2011 ka lidhur marrëveshjen shtesë në vlerë prej 1.025.000,00€ (një milion njëzetepesë mijë euro), më datë 30 Dhjetor 2011 ka lidhur marrëveshjen e ndryshuar RFC në vlerë prej 3.500.000,00 Euro, (tremilionepesëqindmijë euro) dhe me datë 01.11.2012, ka lidhur marrëveshjen në vlerë prej 500.000,00€ (pesëqindmijë euro) dhe gjerë më datë 25 Shtator 2014, kreditorit S. B nuk i ka paguar sipas marrëveshjeve shumën totale prej 26.156.060,26€ (njëzetegjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë euro e njëzetegjashtë cent).

Me këtë nuk u provua se ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil juridik.

II. I akuzuari J.S, për veprat penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si nën pikën II dhe III të dispozitivit të aktakuzës:

ËSHTË FAJTOR

II/1.SEPSE: Në bashkëveprim me personat R.S dhe D.H, kanë mashtruar dhe i kanë shkaktuar dëme kreditorit B. K. T. Degë në Kosovë, - Prishtinë, ashtu që i pandehuri J.S, si Drejtor i Kompanisë C. Shpk Vushtrri, personat D.H, Drejtor Ekzekutiv, i Kompanisë C. Sh.p.k., i pandehuri A.J zyrtar Ligjor dhe agjent i regjistruar i Kompanisë C. Sh.p.k dhe personi R.S, në atë mënyrë që i pandehuri J.S, dhe personi R.S, si kredimarrës me datën 18.04.2013, kanë lidh marrëveshjen për mbitërheqjen (Overdraft/OVD) nr 5418/13 dhe marrëveshjen mbi pengun nr. 5418/13, me kreditorin B. K. T. Dega në Kosovë në vlerë prej 250.000€ dhe janë obliguar se minimumi i pengut që duhet të ruhet sipas kërkesës së kreditorit ka qenë 500.000,00€ dhe janë vonuar në kthimin e mbitërheqjes në shumë prej 250.000.00 euro përfshirë këtu edhe kamatat, kurse kanë shfrytëzuar kolateralin e lënë peng Zink Ajax Bath, 157,860 700ton, @ 1700Euro/ton, në shumën prej 268.000€, Warehouse Stock 178,018tond, @ 1700Euro/ton, në shumën prej 302.000€, metal 99,99% ZNMIN Lme Brend, i regjistruar, tarifa e kodit 79011100, me vlerë të tregut 570.000€, kjo e vërtetuar në bazë të Shënimit Zyrtar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupi i datës 11.07.2014, i cili ka konstatuar se kolaterali i lënë peng nuk gjendet është zhvendosur nga depoja e debitorit peng i regjistruar sipas Kontratës 548/13, ndërsa i pandehuri A.J dhe personi D.H kanë qenë në dijeni për dëmtimin e kreditorit dhe shfrytëzimin e kolateralit të lënë peng dhe shitjen e kolateralit por nuk kanë ndërrmarë ndonjë veprim parandalues dhe me këtë kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale, ndërsa

shuma prej 274.588,62€, kreditorit B. K. T., i është paguar në procedurën e falimentimit datë 08.05.2020, sipas Aktvendimit EN nr.02/2017 dt.30.11.2017 i marrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, sipas fletëpagesës nr.00003796, dft.08.05.2020.

Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III. SEPSE; Me datën 26.02.2014, për t'i shkaktuar dëm kreditorit B. E. në Prishtinë, në cilësinë e Drejtorit të Kompanisë C. Shpk me seli në Vushtrri, ka lidh marrëveshjen kryesore mbi huanë nr.109/5, dhe marrëveshjen mbi pengun nr.109/5 me B. E. në Prishtinë në cilësinë e huadhesit në shumë prej 480,000.00euro, si dhe shtojcën mbi marrëveshjen mbi Pengun në vlerën e mallit prej 825,108.00€ dhe pajisje në vlerë prej 25.441.300€, ndërsa personi (i pandehur) D.H si menaxher i shitjes dhe Drejtor Ekzekutiv i Kompanisë C. Shpk, ka qenë garantues i kësaj marrëveshje dhe që të dy e kanë ditur se parcelat të cilat janë lënë hipotekë P-70202016-02588-1, P.70202016-02590-2 P.70202016-02589-0 dhe P-70202016-0259-1, nuk janë liruar nga hipoteka me ç` rast është realizuar kredia në shumën prej 480.000.00euro, obligimet nuk janë realizuar as përmes kolateralit të lënë peng dhe të dëmtuarës nuk i janë paguar obligimet sipas marrëveshjes, ndërsa shuma prej 496,433,48€, kreditorit B. E. i është paguar në procedurën e likuidimit sipas fletëpagesës nr.00003152, dt.13.05.2020.

Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në bashkim real me veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës.

IV. Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 41, 45, 73 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366 të KPP-së, të akuzuarit i;

SH Q I P T O N

IV/1. Për veprën penale **Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së**, si nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës **DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj.**

IV/2. Për veprën penale **Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së**, si nën pikën III të dispozitivit të aktakuzës **DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj.**

Gjykata në bazë të nenit 80 par.1 lidhur me par.2 nën par.2.2 të KPRK-së, të akuzuarit i:

SH Q I P T O N

DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga dt.26.12.2014 e deri me datë 13.07.2017 dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga datë 13.07.2017 deri me datë 26.08.2017.

Palët e dëmtuara B. K. T. dhe B. E., kanë deklaruar se nuk kanë kërkesa pasurore juridike ndaj të akuzuarve.

OBLIGOHET i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 408.80€ (katërqind e tetë euro e tetëdhjetë cent), paushallin gjyqësor në shumën prej 100€ (njëqind euro) si dhe 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për kompenzimin e Viktimave të

Krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm.

Pas plotëfuqishmërisë së Aktgjykimit, të akuzuarit J.S, i kthehet pasaporta e Britanisë së Madhe me nr.099167055.

V. Të akuzuarit J.S dhe A.J;

Në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si nën pikën IV të dispozitivit të aktakuzës, Gjykata merr këtë vendim:

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Me datë 31.12.2012, i akuzuari J.S si drejtor i Kompanisë C. Shpk, në Vushtrri, ka përpiluar dokument të falsifikuar në lidhje me regjistrin që ruhet në bazë të ligjit-autorizimin për ç`regjistrim të hipotekës dhe kërkesën për ç`regjistrimin e hipotekës në emër të S. B me seli në Londër drejtuar Komunës në Vushtrri- Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, Zyra Kadastrale Komunale në Vushtrri, se i akuzuari J.S që përfaqëson C. SHpk, si huamarrës i ka përmbushur të gjitha detyrimet që dalin nga marrëveshjet me Kreditorin S. B siç theksohet në pikën I të dispozitivit edhe pse nuk është paguar shuma totale prej 26.156.060,26€, ndërsa i pandehuri A.J si zyrtar ligjor me dije i ka përdorur dhe me T. M. A kanë shkuar në Komunën e Vushtrrisë pastaj dokumentet e falsifikuara janë prezantuar në Zyrën Kadastrale Komunale në Komunën e Vushtrrisë, dhe Zyra Kadastrale Komunale merr Aktvendim mbi lirim (shuarjen) e hipoitkës me nr. të protokollit 01/13, dt.10.01.2013.

Me këtë në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, e i akuzuari J.S në bashkim real me veprën penale nën pikën I, II dhe III të dispozitivit të aktakuzës.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

VI. I akuzuari A.J;

Në mbështetje të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për veprën penale Mashtrimi ose dëmtitmi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si nën pikën II të dispozitivit, Gjykata merr këtë vendim:

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE: Në bashkëveprim me personat R.S dhe D.H, kanë mashtruar dhe i kanë shkaktuar dëme kreditorit B. K. T. Dega në Kosovë, - Prishtinë, ashtu që i pandehuri J.S, si Drejtor i Kompanisë C. Shpk Vushtrri, personat D.H, Drejtor Ekzekutiv i Kompanisë C. Shpk, i pandehuri A.J zyrtar Ligjor dhe agjent i regjistruar i Kompanisë C. Shpk dhe personi R.S, në atë mënyrë që i pandehuri J.S, dhe personi R.S, si kredimarrës me datën 18.04.2013, kanë lidhur marrëveshjen për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr 5418/13 dhe marrëveshjen mbi pengun nr. 5418/13, me kreditorin B. K. T. Dega në Kosovë në vlerë prej 250.000€ dhe janë obliguar se minimumi i pengut që duhet të ruhet sipas kërkesës së kreditorit ka qenë 500.000,00€ dhe janë vonuar në kthimin e mbitërheqjes në shumën prej 250.000.00 euro përfshirë këtu edhe kamatat, kurse kanë shfrytëzuar kolateralin e lënë peng Zink Ajax Bath, 157,860 700ton, @ 1700Euro/ton, në shumën prej 268.000€, Warehouse Stock 178,018tond, @ 1700Euro/ton, në shumën prej 302.000€, metal 99,99% ZNMIN Lme Brend, i regjistruar, tarifa e kodit 79011100, me vlerë të tregut 570.000€, kjo e vërtetuar në bazë të Shënimit Zyrtar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj i datës 11.07.2014, i cili ka konstatuar se kolateriali i lënë

peng nuk gjendet është zhvendosur nga depoja e debitorit peng u regjistruar sipas Kontratës 548/13, ndërsa i pandehuri A.J dhe personi D.H kanë qenë në dijeni për dëmtimin e kreditorit dhe shfrytëzimin e kolateralit të lënë peng dhe shitjen e kolateralit por nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim parandalues dhe me këtë kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale, ndërsa shuma prej 274.588,62€, kreditorit B. K. T., i është paguar në procedurën e falimentimit datë 08.05.2020, sipas Aktvendimit EN.nr.02/2017 dt.30.11.2017, i marrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, sipas fletëpagesës nr.00003796, dt.08.05.2020.

Me këtë nuk u provua se i akzuarit A.J ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, si nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës.

Palët e dëmtuara B. K. T. dhe B. E., kanë deklaruar se nuk kanë kërkesa pasurore juridike ndaj të akuzuarve.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

VII. Të AKUZUARIT N.K dhe I.Z;

Në mbështetje të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së për të akuzuarit N.K dhe I.Z, Gjykata merr këtë vendim:

LIROHEN NGA AKUZA

SEPSE; Si persona zyrtar i pandehuri N.K, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër ndërsa i pandehuri I.Z pergjegjes i Sektorit në Kadastër në Komunën e Vushtrrisë duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tyre zyrtar kanë tejkualuar kompetencat e tyre dhe nuk i kanë përmbush detyrat zyrtare me qëllim që të përfitojnë dobi i pandehuri J.S pronar i Kompanisë C. Shpk në Vushtri, në atë mënyrë që të padnehurit edhe pse kanë qenë të obliguar sipas ligjit që të kontrollojnë dhe verifikojnë dokumentet e nevojshme se a plotësohen kushtet për lirim të hipotekës së kredimarrësit C. Shpk me pronar të pandehurin J.S ai ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj kredidhënësit S. B PLC në Londër, këtë nuk e kanë bërë dhe i pandehuri N.K, ka nënshkruar Aktvendimin mbi lirimin (shuarjen) e Hipotekës nr. të protokollit 01/13 Zona Kadastrale Vushtri të dt.10.01.2013, se pengëmarrësit S. B me seli në Londër e atë pronës së paluajtshme e identifikuar me Certifikatën pronësore UL 70202016-003013 ZK Vushtri, në tërësi (të gjitha parcelat) dhe Certifikatat mbi të drejtat në pronën e paluajtshme UL 70202071-00130ZK Shtitaricë në tërësi (të gjitha parcelat) e konstituara në bazë të Aktvendimit 73/2011, 78/2011, 91/2011 dhe 02/2012 krijuar në mes të pengdhënësit) borxhliu-garantues) C. SH.P.K me Seli në Vushtri dhe pengmarrësit (kreditori) S. B me seli në Londër për kredinë në vlerë prej 9.457.090€, (nëntë milion e katërqinde pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë euro), 3.000.000,00 euro (tremilion euro), 1.025.000,00€ (një milion e njëzet e pesë mijë euro), dhe 500.000,00€ (pesëqind mijë euro) me prioritetin e parë I, dytë II, tretë III dhe katërt IV, të regjistruara ndërsa i pandehuri I.Z ka përpiluar Aktvendimin e cekur mbi lirimin (shuarjen) e hipotekës pa i përmbushur obligimet Kredimarrësi - i pandehuri J.S si pronar i Kompanisë C. SH.P.K në Vushtri ndaj kreditorit S. B me seli në Londër e sipas autorizimit dhe kërkesës të datës 10.01.2013, që ka qenë e pavulosur nga ana e S. B me seli në Londër, kurse me vule Zyra për Përkthime Aulona pa adresë dhe i pa nënshkruar.

Me këtë nuk u provua se të akuzuarit N.K dhe I.Z kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale mbesim në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

I. Rrjedha e procedurës

Prokuroria Themelore Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë ka parashtruar Aktakuzën PP.I.nr.303/2014 dt.30.07.20215, kundër të akuzuarit J.S për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, të akuzuarve J.S dhe A.J për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarit J.S për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, të akuzuarve J.S dhe A.J për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarve N.K dhe I.Z për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Fillimisht, Kryetari i trupit gjykues konstaton se kjo lëndë P.nr.128/2015, i është caktuar si kryetar i trupit gjykues që nga dt.02.10.2019, për shqyrtim, me të cilën lëndë paraprakisht kanë qenë të ngarkuar gjyqtarë të tjerë, siç konstatohet në shkresat e lëndës, pastaj pas pranimi fizik të lëndës kemi ndërmarrë veprime procedurale lidhur me çështjen për caktimin e seancave të shqyrtimit gjyqësor, po ashtu konstatoj se në këtë çështje penale paraprakisht janë ndërmarrë veprime ligjore nga ana e Gjykatës gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor, veprime të cilat do të konstatohen në vijim të pjesës arsytuese të këtij Aktgjykimi, të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, si pranë Institucioneve të autorizuara ligjore vendore po ashtu edhe përmes Departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Gjykata ka caktuar seancat e shqyrtimit gjyqësor me dt.09.06.2021, dt.08.09.2021, dt.20.10.2021, dt.13.12.2021, dt.27.01.2022, dt.07.03.2022 dhe dt.15.03.2022, në të cilat seanca kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësi av.Abit Asllani. Shpallja publike e Aktgjykimit është bërë me dt.18.03.2022, në mungesën e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit J.S dhe N.K, kurse në prezencë të akuzuarve A.J dhe I.Z.

Gjykata për seancat e shqyrtimit gjyqësor i ka ftuar edhe përfaqësuesit e palëve të dëmtuara S. B PLLC me seli në Londër Britani e Madhe, B. E. dhe B. K. T..

B. K. T. e ka njoftuar Gjykatën përmes parashtresës së dt.04.06.2021, e kanë si palë e dëmtuar BKT Kosovë Sh.A, se përmes procedurës së falimentimit ndaj subjektit të falimentimit Kompania C. Sh.P.K, e cila është zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike me numër të rastit II.L.2/16 (EF.nr.01/2015) e ka realizuar në tërësi borxhin ne shume prej 274.588,62€ ndaj Kompanisë C. Sh.P.K, ndërsa sa i përket pretendimeve për kryerjen e veprës penale ndaj të akuzuarve, mbesim në tërësi pranë pretendimeve nga shkresat dhe deklaratimet në seancat e kaluara.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar B. E. e ka njoftuar Gjykatën në seancën e dt.09.06.2021, se borxhin ne Shumen prej 496.433,48€, nga ndërmarrja e të pandehurit e ka inkasuar përmes procedurës së falimentimit nga Kompania C. Shp.P.K, andaj edhe nuk ka më interes që të marrë pjesë në seancë në cilësinë e palës së dëmtuar.

S. B PLLC me seli në Londër Britani e Madhe përmes parashtresës së dt.20.10.2021 me të cilën i është drejtuar Gjykatës se nuk do të prezentojnë në seancë pasi që ka ndryshuar pronësia dhe struktura e bankës dhe si rezultat një numër i ish punonjësve nuk janë pjesë e bankës dhe banka nuk është në gjendje të sigurojë një përfaqësues të përshtatshëm i cili do të ishte në gjendje të merrte pjesë në dëgjimin dhe dhënien e dëshmimeve përkatëse andaj në këto rrethana

banka nuk ndihet në gjendje të veprojë si dëshmitare ose të marrë pjesë ndryshe në këto procedura.

Bazuar në të lartcekurat Gjykata ka procedura tutje me seancat e shqyrtimit gjyqësor pa përfaqësuesit e palëve të dëmtuara të cilat janë cekur si në Aktakuzë.

II. Fjala përfundimtare.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësore me dt.15.03.2022, Prokurori i Shtetit dhe të akuzuarit kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbës në tërësi pranë aktakuzës së ngritur mendoj që në shkresat e lëndës ka mjaftueshëm dëshmi në bazë të së cilave është ngritur aktakuza, andaj gjykatës i propozoj që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

I akuzuari J.S fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim në 5 faqe të formatit A4 dhe të njëjtën e ka elaboruar me gojë ku ka deklaruar se Prokuroria në asnjë pikë nuk e ka mbështetur akuzën në prova dhe gjykata të merr aktgjykim lirues në raport me mua.

I akuzuari J.S fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim në 4 faqe të formatit A4 dhe të njëjtën e ka elaboruar me gojë.

Mbrojtësi I të akuzuarit N.K, av.Abit Asllani fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim në 5 faqe të formatit A4 dhe të njëjtën e ka elaboruar me gojë.

I akuzuari N.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndroj pranë fjalës përfundimtare të prezentuar me shkrim nga ana e mbrojtësit tim si dhe atë që e elaboroj me gojë gjatë fjalës përfundimtare duke shtuar se nuk e ndiej vetën fajtor.

I akuzuari I.Z në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Prokuroria e Shtetit në rastin konkret nuk ka pasur prova dhe fakte për ngritjen e aktakuzës kjo është dëshmuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe Prokuroria e Shtetit është dashur që të hjek dorë nga ndjekja penale dhe jo ne të ballafaqohem më shumë se 7 vite në këtë proces gjyqësor, asnjë element që i përket veprës penale nuk është vërtetuar nga ana e Prokurorisë, trupit gjykues i propozoj që të merr aktgjykim lirues për këtë çështje.

III. Marrja në pyetje e dëshmitarëve

Në seancën e dt.27.01.2022, Prokurori i Shtetit ka propozuar pasi që dëshmitarët T. M. A dhe Sh.J janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve në seancën e dt.15.03.2016, ne nuk kemi për të kërkuar sqarime shtesë për të njëjtit andaj propozoj që të lexohen deklaratat e tyre të dhënë në atë seancë.

Të akuzuarit kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje dhe pajtohen me propozimin e Prokurorit të Shtetit. Trupi gjykues në bazë të nenit 338 par.1 në par.1.3 të KPP-së dhe ka lexuar *Deklarata e dëshmitares T. M. A e dhënë me dt.15.03.2016 në seancën e shqyrtimit gjyqësor* dhe *Deklarata e dëshmitarit Sh.J e dhënë me dt.15.03.2016 në seancën e shqyrtimit gjyqësor*.

Dëshmitarja T. M. A në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.03.2016, ka deklaruar se kam punuar në fabrikën “LI” në Vushtrri që nga viti 2011 e deri në vitin 2013, kam qenë asistente-sekretarëshë e J.St, detyrat e mia kanë qenë: evidenca e mbledhje ve të cilat i ka pasur, lajmërimi në telefon, shërbimi i klientëve, shërbimi i kafesë dhe çfarëdo kërkesa tjera që ka pasur në bazë të hierarkisë, J.S kryesisht nuk ka qenë këtu, kam pasur kontratë pune, kam kryer

kryesisht punë administrative, drejtor gjeneral aso kohe sa kam punuar unë ka qenë P.C, J.S nuk ka qenë drejtor, ka qenë pronar, gjatë kohës kur kam punuar kam pasur kontakt me të akuzuarin lidhur me punën, kam qenë në Shërbimin Kadastral të Komunës së Vushtrrisë ku e kam dorëzuar një kërkesë përmbajtjen e së cilës nuk e kam parë pasi që ka qenë në një zarf A4 të mbyllur, dhe të njëjtin jam urdhëruar t'a dorëzoj në Kadastër të Komunës së Vushtrrisë, nuk kam kontaktuar me asnjë person, kam shkuar bashkë me shoferin tonë dhe në Kadastër e kam dorëzuar atë zarf, nuk më kujtohet kujt ia kam dorëzuar, P.C më ka thënë “ T., a mund t'a dorëzosh këtë zarf në kadastër?”, nuk ka pasur asnjë mbishkrim në zarf, aq sa di unë nuk kemi zhvilluar asnjë takim me përfaqësuesit e S. B, nuk më është dorëzuar asnjë dëshmi se e kam dorëzuar atë dokument (Zarfin e bardhë), kur e kam dorëzuar Zarfin në Shërbimin Kadastral nuk më ka pyetur askush se çfarë është ky zarf, vetëm e kam dorëzuar, nuk kam kryer asnjë pagesë me rastin e dorëzimit të zarfit, zarfin e kam dorëzuar kah fundi i vitit 2012 dhe fillimi i vitit 2013, mirëpo nuk më kujtohet saktë kur e kam dorëzuar, me të akuzuarin A.J kam punuar, i njëjti ka punuar për shërbime juridike dhe burime njerëzore, nuk kam qenë e autorizuar nga S. Ba për këtë rast, autorizimin me të cilin kam qenë e autorizuar për çregjistrimin e hipotekës në emër të S. Bës e kam parë kur kam qenë në Prokurori dhe nuk kam asnjë koment për të njëjtin, nuk kam aranzhuar asnjë takim mes J.St dhe përfaqësuesit të S. Bës, nuk kam qenë në dijeni për marrëveshjet që J.S i ka lidhur me S. Bën, në takimet e rëndësishme për mbarëvajtjen e punës kur nuk ka qenë J.S, atë e zëvendësonte drejtori gjeneral P.C, kontratën e punës në cilësinë e punëdhënësit e ka nënshkruar drejtori gjeneral, nuk kam qenë në dijeni për një autorizim të tillë as nga J.S dhe as nga R.S, zarfin nuk e di se në cilin kat e kam dorëzuar, e di që nuk ka qenë kati përdhese pasi që më është dashur të ngjitem shkallëve, mendoj të këtë qenë kati i I-rë, kërkesën që është pjesë e arkivës së Kadastrit e që mbanë të dhënat e mia si parashtruese e kërkesës po e shoh por unë nuk po e shoh të jetë nënshkruar nga ana ime, çdo i punësuar e doëzon kopjen e letërnjoftimit në burime njerëzore, dhe një kopje të tillë kam përshtypjen që mund të sigurohet dhe shfrytëzohet në çfarëdo mënyre, nuk kam koment se si në fletëpagesën e cila gjendet në shkresat e lëndës, në të njëjtën gjendet emri im, mirëpo në këtë fletëpagesë nuk është nënshkrimi im, ka qenë praktikë e drejtorit gjeneral që shkresat që i kam dorëzuar në insitucione më janë dhënë në zarfe të mbyllura, nuk më ka pyetur nëse i kam dorëzuar ose jo, ne kemi mbajtur protokoll brenda ndërmarrjes ku kam qenë e punësuar dhe protokollin e ka mbajtur menaxhmenti i huaj, nuk kam pasur çasje në këtë protokoll, shkresat që i kam dorëzuar vetëm ia kam komunikuar hierarkisë zyrtare se shkresa ka shkuar tek njeriu i duhur, nuk më është thënë se cili është njeriu që duhet t'ia dorëzoj shkresat, por më është thënë tek vendi i duhur, pranuesi i zarfit nuk e di a e ka protokolluar atë zarf apo jo.

Dëshmitari Sh.J në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.03.2016, ka deklaruar se në zyrën e përkthimeve mbajmë evidencë për dokumentet përkthimet e të cilave i bëjmë, nuk më kujtohet të kem përkthyer kërkesë për çregjistrimin e hipotekës në emër të S. Bës drejtuar Komunës së Vushtrrisë, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, përkthimi i prezantuar nga ana e Prokurorisë nuk është nga kompania jonë, pasi që nënshkrimi nuk është i imi, vulën mund t'a verifikoni, por edhe përmbajtja e këtij dokumenti dallon me dokumentet që ne i përkthejmë pasi që ne çdo herë kur përkthejmë një dokument, në atë dokument cekim se nga cila gjuhë në cilën gjuhë është përkthyer, po ashtu shënojmë datën e përkthimit dhe logon e kompanisë tonë, ku para Gjykatës po ua deponoj një formë të formatit që e kemi për përkthime, nuk kam pranuar asnjë kërkesë për përkthim nga S. Ba, nga policia më është thënë kinse A.J më ka dërguar me e-Mail një dokument të tillë për t'ia përkthyer, i kam dy e-Mail-a që i shfrytëzoj që janë Sh.P@gmail.com dhe info@përkthime-....com , dhe këto dy e-Mail unë kam kërkuar nëse kam një kërkesë të tillë nga A.J por nuk kam hasur më ndonjë e-Mail të dërguar nga zotëria në fjalë, punoj vetëm në zyre por më raste kur shkoj për ndonjë pushim të shkurtër 2-3 ditë e më dikë në zyre, në rastin konkret nuk kam qenë në Kosovë por kam qenë në Shqipëri dhe në zyre ka qenë vëllai im Q.J, vëllait i është kujtuar A.J kur e kemi parë në fotografi se i njëjti ka qenë për përkthim të një dokumenti tjetër, por jo të këtij që bëhet fjalë për S. B, nuk e kemi në evidencë

se një dokument i tillë është përkthyer tek në, nuk kam punuar diku tjetër përveç në zyrën e përkthimeve , me vëllain tim komunikoj me dy e-Mail-a dhe atë ...@gmail.com dhe ...@hotmail.com, kam kërkuar edhe në këto e-Mail-a për një shkresë të tillë mirëpo nuk i kam gjetur, pasi që e shikoj këtë dokument nuk mund të them se jam i sigurt që nuk është nënshkrimi i tij, nuk kam pranuar dhe as që do ta pranoja një dokument të përkthyer vetëm për vërtetim të përmbajtjes pasi që nuk mund të garantojmë se përkthimi është qind për qind me origjinalin e gjuhës së saktë, kam biseduar me vëllain dhe ai më ka sqaruar se A.J i ka kërkuar atij që për shkak se dokumenti është konfidencial, ai dokument nuk mund të mbetet në zyrën tonë dhe i ka kërkuar që t'a fshijë apo diçka të tillë, po ashtu vëllai më ka thënë se dokumenti që është kërkuar nga ana e tij ka pasur tekst në pjesën e sipërme të faqës dhe jo në tërësi sikurse që është ky, dhe po ashtu vëllai më ka thënë se A.J i ka kërkuar atij që ai dokument vetëm të jetë i vulosur pa elemente tjera përbërëse që ne i kemi në dokumentet tjera të përkthimit dhe ka kërkuar që ai dokument të këtë vulën e pastër që të mund të lexohet dhe të mos jetë e nënshkruar tek pjesa e vulës, për atë dokument që e sqarova se ka pasur tekst vetëm gjysmën e faqës unë kam qenë në dijeni dhe e kam kuptuar se kemi të bëjmë me sekret afarist dhe si të tillë e kam miratuar, por për dokumentin e S. Bës as atëherë nuk kam qenë në dijeni dhe jam njoftuar vetëm kur ka ardhur zyrtari i policisë në zyre dhe ka kërkuar nga unë që të sqaroj se a është ky dokument i përkthyer nga zyra jonë apo jo, e kam aprovuar një kërkesë të tillë nga ana e A.Jt që të mos e mbajmë atë dokument në zyre pasi që sipas palës, ai ka qenë dokument konfidencial dhe po ashtu nuk e kam regjistruar si të tillë dhe ky është vetëm rast përjashtim për shkak se ka qenë kërkesë eksplicite e A.Jt me arsyetimin se ky është një sekret afarist dhe dokumentin origjinal në gjuhën angleze të S. Bës nuk e kam parë, ka mundësi që të jem njoftuar me përmbajtjen e atij dokumenti nga vëllai përmes telefonit për shkak të sekretit afarist dhe i njëjti të mos jetë dërguar fare përmes e-Mail-it, nuk më kujtohet saktësisht se si i kam lejuar vëllait për të bërë një përkthim përmes telefonit se si i kam thënë që t'a përkthejë, vëllai im nuk bën përkthime, për një dokument të tillë si ai i S. Bës në e-Mail-at e mia as tek vëllai nuk kam evidenca, por është dashur që të regjistrohet një kërkesë e tillë edhe në regjistrat tonë si përkthim konfidencial.

IV. Provat e administruara

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar këto prova: *Kërkesën për çregjistrimin e hipotekës e dt.31.12.2012 të S. B drejtuar Komunës në Vushtrri-Drejtoria për kadastrë, gjeodezi dhe prona-zyra kadastrale komunale në Vushtrri së bashku me autorizimin për çregjistrimin e hipotekës, Aktvendimi mbi lirimin (shuarjen) e hipotekës Zyra Komunale Kadastrale në Vushtrri nr. i protokollit 01/13 i dt.10.01.2013, Përgjigja e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastrë në Komunën e Vushtrrisë referncë 18 nr.93/14 e dt.18.08.2014, Shkresën-dëshminë e parë nën betim të J. D. G. H. nga S. Ba me seli në Londër të dt.16.09.2012 të vërtetuar tek noteri, Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës Komuna e Vushtrrisë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë nr.protokolli 13/2014 i dt.28.02.2014, Formularin për kërkesë apo ankesë Komuna e Vushtrrisë e dt.27.02.2014, Kopjen e faturës me nr.serik 004818 Komuna e Vushtrrisë Drejtoria për Kadastrë dhe Gjeodezi, Kontratën marrëveshjen kryesore nr.109/5 B. E., Kontrata mbi hipotekën LRP.nr. rendor 462/1035/2014 noter B. A. D. Vushtrri rr. "Wesli Clark", Certifikata mbi regjistrimin nr. i biznesit 70758695 të MTI-Agjencioni i regjistrimit të bizneseve në Kosovë të dt.16.11.2011, Certifikata e pronës së bashku me fletëtregues dhe kopjen e planit të Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë të dt.20.02.2014 dhe të dt.02.02.2012, Certifikatë Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për buxhet, financa dhe thesar 06 nr.308 të dt.27.02.2014, Përgjigjen e NCA Ambasada e Britanisë së Madhe në Tiranë ref.nr.2014-003-001, Përgjigjen e B. E. në Prishtinë të dt.25.11.2014, Aktvendimet mbi regjistrimin e hipotekës nr. i protokollit 73/2011 të dt.26.08.2011, 78/2011, 79/2011 së bashku me listat poseduese të Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë, Kontratat hipotekë të dt.06 dhe 25.08.2011 dhe 04.11.2011 së bashku me listën e asetëve midis palëve S. B PLC në Londër dhe C. SHPK në Prishtinë, Prokurën e posaçme nr. i ref.SB PLC e prokurën e përgjithshme të vërtetuar në Gjykatën Komunale-*

Vushtrri të dt.19.10.2011, Aktvendimin mbi regjistrimin e hipotekës Komuna Vushtrri-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë nr. i protokollit 02/12 të dt.12.01.2012, Aktvendimin Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Gjeodezië, Kadastër dhe Pronë nr. i lëndës/protokollit 403/2011 i dt.25.08.2011, Marrëveshjen për shitblerjen lidhur me shitjen përmes likuidimit të aseteve të caktuara të ndërmarrjes së re Ll STEEL SH.P.K, Marrëveshjen për mbitërheqjen (Oërdraft/OVD) nr.5418/13 dhe marrëveshjen mbi pengun nr.5418/2013 të dt.18.04.2013 të BKT në Prishtinë, Shënimi zyrtar te përmbartuesi privat D.B lënda Pnr.109/14 të dt.11.07.2014, Konkluzioni Komuna e Vushtrrisë Drejtoria për Gjeodezië, kadastër dhe Pronë nr.124-54720 të dt.19.12.2012, Aneks kontrata e punës dhe kontratën e punës për kohë të caktuar nr.138 e dt.01.01.2013 të lidhur në mes të C. SHPK Ll GalvaSteel dhe punëmarrësit të pandehurit A.J, Pasaporta nr.099167055 në emër të pandehurit J.S, Ekspertiza Financiare Nr.060/2017 e dt.12.07.2017 e kryer nga Eksperti Financiar Dr.sc.V.I, Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë nr.AKF/2016-1693/2016-1422 e dt.17.08.2016, Propozimi – Kërkesa për inicimin e procedurës së falimentimit i dt.21.01.2015, Kopje e Aktvendimit EF.nr.2/2016 e dt.02.12.2016 nga Gjykata Themelore Prishtinë, Raportet e administratorit falimentues duke përfshirë edhe raportin përfundimtar, shpalljen publike të falimentimit, lista përfundimtare e kreditorëve, organizimi i ankandit publik, kontrata e shitjes së asteve, shpërndarja e mjeteve kreditorëve, Ankesa e parashtruar nga Administratori Falimentues kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë EF.nr.2/2016 e dt.19.12.2016, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, Aktvendimi për përfundimin e procedurës së falimentimit EF.nr.2/2016 i dt.22.07.2020, Marrëveshja mbi pengun nr.85213/85214 e dt.26.02.2014 në mes të B. E. dhe Ndërmarrjes C. Sh.P.K nga Vushtrria, Marrëveshja kreditore për kredi-aneks i marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes Nr.109/5 e dt.26.02.2014 me nr.8521/5 me B. E. dhe ndërmarrjes C. Sh.P.K nga Vushtrria, Marrëveshja kreditore për mbitërheqje-ankes i marrëveshjes kryesore të produkteve për biznes nr.105/5 në mes të B. E. dhe C. Sh.P.K nga Vushtrria, nr.85214 e dt.26.04.2014, Kontratë hipoteke e dt.11.01.2012 me nr.VR.Nr.42/2012 në mes të S. B P.L.C në Londër dhe C. Sh.P.K, Përgjigje e AKP-së me nr.2881/AV e dt.20.04.2016, Autorizimi për çregjistrim të hipotekës i dt.08.01.2013, Certifikatë e palujtshmërisë e dt.06.02.2015 për personin C. Sh.P.K, Marrëveshje për mbi tërheqje nr.4261/2012 e dt.05.03.2012 në mes të kredidhënësit BKT dhe kredimarrësit kompania C. Sh.P.K, Autorizimet e përgjithshme i dt.01.09.2011 të dhënë nga përfaqësuesi i autorizuar i C. Sh.P.K, i caktuar si i autorizuar A.H dhe Autorizim për përfaqësim për A.J i nënshkruar nga J.S i dt.19.12.2011, Përgjigje e dhënë nga BQK-ja datë 21.04.2016 për Gjykatën Themelore Mitrovicë, Përgjigje e dhënë nga Raiffeisen Bank për Gjykatën Themelore Mitrovicë, datë 06.04.2016, Përgjigje e dhënë nga ARBK sektori – zyra e pengut e dt.06.04.2016.

Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësi nuk kanë pasur propozime për plotësimin e procedurës së provave.

V. Marrja në pyetje e të akuzuarve

Në seancën e dt.15.03.2022, të akuzuarit janë udhëzuar për të drejtat e tyre në bazë të nenit 323 dhe nenit 346 të KPP-së.

I akuzuari J.S ka deklaruar se e shfrytëzon të drejtën e tij ligjore që të mos deklarohet në këtë çështje.

I akuzuari A.J ka deklaruar se e shfrytëzon të drejtën e tij ligjore që të mos deklarohet në këtë çështje.

I akuzuari N.K ka deklaruar se e shfrytëzon të drejtën e tij ligjore që të mos deklarohet në këtë çështje.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se është e drejtë ligjore nga neni 346 par.1 të KPP-së që të akuzuarit të mos deklarohen lidhur me çështjen.

I akuzuari I.Z është deklaruar lidhur me çështjen dhe i njëjti ka deklaruar se në vitin 2013 kam qenë i ngarkuar me punën Shef i Sektorit për Kadastër, Drejtoria i ka dy sketore Gjeodezi dhe Kadastër unë kam qenë për Kadastër, obligimet dhe detyrat e mija si shef kanë qenë përpilimi i aktvendimeve për bartjen e pronës, përpilimi i aktvendimeve për uzurpim, përpilimi i aktvendimeve për regjistrim dhe lirim të hipotekave, sa i përket regjistrimit të hipotekave pas kërkesave të bankave i kemi përpiluar lëndët dhe i kemi regjistruar gjithashtu sa i përket lirimeve të hipotekave pas kërkesave të bankave për lirim të hipotekave kemi administruar lëndë dhe kemi përpiluar aktvendime nëse kanë qenë konfor ligjit, kjo procedura edhe tash shkon ashtu, vetëm tani shkon online procedura për paraqitjen e kërkesave jo nëpërmes zyrës së pranimit siq ka qenë përpara, ligji për hipotekat kjo rregullon çështjen e lirit të hipotekave dhe jashtë kërkesave që i parasheh ligji nuk kemi vepruar, ligji e parasheh që kredimarrësi 15 ditë mbasi që i përmbushë obligimet banka është e detyruar që të paraqet kërkesën për lirim, ti bashkëngjis edhe dokumentet e tjera për dëshminë që është paguar kredia, nuk më kujtohet a ka mundur që të ketë raste që kemi refuzuar kërkesën, mirëpo nëse nuk plotësohen kushtet sipas ligjit refuzohet kërkesa ose kërkohet dokumentacion shtesë nëse është e mundshme, rasti i datës 21.05.2015 edhe pse ka kaluar kohë e gjatë mirëpo më kujtohet gjithsesi dhe në tërësi është vepruar konform ligjit për hipotekat që e rregullon këtë çështje, në përpikëmeri është respektuar procedura në rastin konkret vendimin për lirim të hipotekës e nënshkruan personi që e administron lëndën dhe drejtori i drejtorisë, në këtë rast administratori i lëndës kam qenë unë, për herë të parë kemi dëgjuar për atë subjekt S. B dhe ka qenë hera e parë që kemi pasur rast me një bankë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, nuk më kujtohet a e kam njoftuar eprorin tim për “elementin e huaj por nëse një kontratë vërtetohet në gjykatë jemi të obliguar për të vepruar, nuk kam pasur njohuri që S. B, është vërtetuar edhe më vonë nga BQK-ja që nuk ka pasur licencë, por sidoqoftë ne nuk lëshohemi në interpretimin e vendimeve apo vërtetimeve nga ana e gjykatës apo organeve të tjera vetëm nëse ka ndonjë gabim teknik apo diçka të tillë.

VI. Gjetjet e Gjykatës në raport me gjendjen faktike

VI.1. Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata ka vlerësuar provat, faktet dhe rrethanat lidhur me pikën I të dispozitivit të Aktakuzës dhe ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata thekson se për tu konsideruar se është kryer një veprë penale duhet që të plotësohen elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta të asaj veprë penale, konkretisht të përmbushet figura e veprës penale. Në rastin konkret sipas pikës I të dispozitivit të Aktakuzës, i akuzuari J.S është akuzuar për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Sa i përket elementeve të veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, Gjykata thekson se tek kjo veprë penale sipas paragrafit 2 ka karakter mashtrues, sepse kryerësi i kësaj veprë penale i ndërmerr veprimet ndëshkuese me qëllim që të mashtrrojë apo shkaktojë dëm ndonjë kreditor apo debitor. Veprimet me të cilat kryhet kjo formë e veprës penale janë të përcaktuara në par. 2 të këtij neni si për shembull, a) duke pranuar kërkesat e pa vërteta, b) duke lidhë kontrata të rrejshme apo me veprime tjera mashtruese me të cilat dëmton ndonjë kreditor apo debitor, c) me qëllim të dëmtimit të kreditorëve apo debitorëve ndërmerr veprime mashtruese juridike, apo d) ndonjë veprim tjetër mashtrues dëmton kreditorin apo debitorin e organizatës së biznesit apo të personit juridik. Me ndërmarrjen e këtyre veprimeve krijohen detyrime fiktive, kreditor fiktiv apo debitor fiktiv ashtu që hyrja e kreditorëve fiktiv apo

debitorëve fiktiv në rrethin e kreditorëve apo të debitorëve e zvogëlon mundësinë e realizimit të kërkesave. Kurse në paragrafin 3 të këtij neni janë paraparë format e kualifikuara të kësaj vepre penale për shkak të lartësisë së dëmit apo humbjes së shkaktuar (që kalon shumën prej 250.000 euro) apo kur pala e dëmtuar si pasojë e njëres vepër është detyruar t'i nënshtrohet riorganizimit ose procedurës së falimentimit.

Gjykata ka shqyrtuar pikën I të dispozitivit të Aktakuzës dhe thekson se në përshkrimin si në pikën I të dispozitivit të Aktakuzës vepra penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, si elemente inkriminuese të veprës penale për të cilat është akuzuar se i ka ndërmarrë i akuzuari J.S është “mashtrimi dhe shkakimi i dëmit kreditorit S. B PLC me seli në Londër”, pasi që janë lidhur kontratat mbi huanë dhe nuk i është paguar sipas marrëveshjeve shuma totale prej 26.156.060,26 Euro.

Gjykata thekson se në rastin konkret Prokuroria, si veprim inkriminues është ndërlidhur tek elementi i “mashtimit të kreditorit” S. B PLC me seli në Londër, për kualifikimin e veprës penale për të akuzuarin me paragrafin 2 të nenit 289 të KPRK-së, dhe pasi që shuma e “dëmit të shkaktuar” është mbi 250.000 euro, është forma e kualifikuar nga paragrafi 3 i veprës penale nga neni 289 të KPRK-së.

Gjykata thekson se në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe mbi këtë bazë nuk është provuar se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit, me arsyet faktike që do të konstatohen me poshte;

Gjykata fillimisht sqaron faktin se me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka marrë prova të reja për të vërtetuar faktet e çështjes në raport me Aktakuzën e ngritur, të cilat prova i ka administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe atë Aktvendimin EN.nr.02/2017 të dt.30.11.2017, nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë.

Gjykata sqaron se në pikën 1.1 të dispozitivit të këtij Aktvendimi e Gjykates se Apleit e Kosoves ne Prishtine EN.nr.02/2017 të dt.30.11.2017, është vendosur si në vijim: “REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesa e S. B, me seli në Londër, me të cilën ka kërkuar që t'i njihet kërkesa monetare prej 27,588,908.66€”.

Gjykata e Apelit në Aktvendimin e lartcekur në arsyetimin e saj si në faqen 5 ka konstatuar se “Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale kur e ka aprovuar kërkesën e S. B PLC sepse nga gjendja faktike kjo gjykatë vlerëson se nuk ekziston obligimi i debitorit (i referohet C. SH.P.K) ndaj kreditorit (i referohet S. B PLC tani pale e demtuar si ne aktakuze), nga arsyeja se kreditori nuk ka ofruar prova të besueshme dhe bindëse për ti provuar pretendimet e tij”.

Gjykata e Apelit në Aktvendimin e lartcekur në arsyetimin e saj si në faqen 6 ka konstatuar se “Sipas qëndrimit të Gjykatës së Apelit, pavarësisht faktit nëse një kontratë e huas ka ekzistuar apo jo, borxhi nga kontrata e huas lind tek debitori me rastin e pagesës së mjeteve nga ana e kreditorit. Nëse kreditori nuk ka paguar mjete në emër të huas, atëherë edhe nuk mund të kërkohej kthimi i borxhit. Në procedurën gjyqësore kreditori (i referohet S. B) nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se mjetet nga huaja janë paguar.”

Po ashtu në këtë Aktvendim të Gjykatës së Apelit është konstatuar se “Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë fare për bazë kundërshtimin e Debitorit se Kreditori (i referohet S. Bës) nuk ka autorizime ligjore për dhënien e kredive Komerciale në Republikën e Kosovës. Sipas dispozitës së Nenit 5 par.4 të Ligjit për Bankat Institucionet mikrofinanciare dhe

Institucionet financiare jobankare (Ligji Nr.04/L-093) ‘*Asnjë bankë e huaj nuk lejohet të angazhohet në veprimtari bankare në Kosovë përveç nëse banka e huaj ka marrë një licencë të lëshuar nga BQK-ja për të ushtruar një veprimtari e tillë nëpërmjet një dege në Kosovë apo ka themeluar një bankë të varur në Kosovë për të cilën BQK-ja ka lëshuar licencë*’. Ndërsa pretendimi i përfaqësuesit të kreditorit se kreditori ka fituar autorizime ligjore për dhënien e kredisë në Bazë të Ligjit për Investimet e Huaja (Ligji Nr.02/L-33) përbën pretendim kontradiktor me pretendimet tjera të Kreditorit sepse nëse shuma e të hollave të cilat Kreditori pretendon se i janë dhënë Debitorit, do të konsiderohej si Investim i huaj në shoqërinë tregtare vendore, atëherë sipas nenit 2.1 të Ligjit të cituar, Kreditori do t’i takonin interesa pronësore në shoqërinë tregtare dhe do ta ndante fatin e shoqërisë, e jo të paraqitej si kreditor në procedurën e Falimentimit.”

Gjykata në rastin konkret gjenë se nuk janë plotësuar elementet e veprës penale Mashtrimi apo dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.2 lidhur me par.3 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret nga baza ligjore, dhe provave të vërtetuara në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, i cekur si më lart, nuk ka mund të jetë në cilësinë e kreditorit S. B PLC me seli në Londër.

Ky konstatim i Gjykatës bazohet pikërisht në Aktvendimin EN.nr.02/2017 të dt.30.11.2017, nga Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ku konstatohet se S. B PLC me seli në Londër nuk e ka pasur cilësinë e kreditorit në raport me “C. Sh.P.K me seli në Vushtrri. Gjykata sqaron se bazuar në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 të dt.30.11.2017, është vërtetuar fakti kryesor në raport me çështjen penale nga pika I e dispozitivit të Aktgjykimit, ku në këtë rast duke theksuar se nuk ka pasur kreditor konkretisht S. B PLC me seli në Londër nuk e ka pasur cilësinë e kreditorit në raport me “C.” SH.P.K me seli në Vushtrri në të cilën i akuzuari J.S ka pasur cilësinë e drejtorit të kompanisë “C.” SH.P.K. Gjykata në rastin konkret edhe në raport me çështjen penale gjenë se mungojnë prova të cilat i vërtetojnë faktet kryesor të çështje pikërisht duke u bazuar në faktin se në rastin konkretë nuk ekziston një kontratë origjinale mbi huanë e lidhur në mes C. SH.P.K dhe S. B PLC me seli në Londër, e për më tepër duke u bazuar në faktin se S. B nuk ka pasur të drejtën ligjor që të operoj në Republikën e Kosovës për lëshimin e kredive komerciale e që ky fakt vërtetohet edhe nga provat siç është ***Përgjigja e dhënë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK-j) datë 21.04.2016 për Gjykatën Themelore Mitrovicë***, ku është theksuar se S. B nuk e ka pasur të drejtën ligjor konkretisht nuk ka qenë e licensuar për kryerjen e aktiviteteve të tilla financiare.

Andaj në rastin konkret Gjykata duke pasur parasysh se nuk e kemi subjektin e njohur (S. B PLC me seli në Londër) në mënyrë ligjore në cilësinë e kreditorit si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit, atëherë Gjykata vlerëson se nuk mund të kemi elementet e veprës penale Mashtrimi apo dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.2 lidhur me par.3 të KPRK-së, pasi që mungon subjekti – kreditori, andaj në këtë rast nuk mund të thirremi në elementet e tjera të veprës penale siç është “mashtrimi i kreditorit” apo “shkaktimi i dëmit kreditorit”. Edhe pse në rastin konkret mungon subjekti i dëmtuar apo i mashtruar në këtë rast kreditori, Gjykata thekson se nuk është e domosdoshme që të lëshohet në vërtetimin e fakteve të tjera siç është “mashtrimi i kreditorit” apo “shkaktimi i dëmit kreditorit”, mirëpo Gjykata në rastin konkret edhe pse nuk e sheh të obligueshme këtë sqarim prapë se prapë do të lëshohet në sqarimin e këtyre rrethanave. Fillimisht në rastin konkret mungon element i “mashtimit të kreditorit”, pasi që në rastin konkret si në pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit dhe Aktakuzës subjekti “S. B PLC me seli në Londër” nuk e ka pasur cilësinë e kreditorit në raport me “C. SH.P.K me seli në Vushtrri”, siç është konstatuar në Aktvendimit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017 të Gjykatës së Apelit, andaj mungon ky element në raport me veprën penale, po ashtu mungon edhe elementi i “shkaktimit të dëmit”, pasi që në rastin konkret sipas Aktvendimit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017 të Gjykatës së Apelit, është refuzuar në tërësi si e

pabazuar kërkesa e S. B me seli në Londër, me të cilën ka kërkuar që t'i njihet kërkesa monetare prej 27,588,908.66€.

Prokuroria nuk i merr për bazë vendimet e plotëfuqishme të Gjykatës dhe atë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës EN.nr.02/2017, dt.30.11.2017, ku ka vërtetuar se S. B, nuk e ka të drejtën e kreditorit, pasi që nuk është e licencuar nga autoriteti i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës që të veprojë-operojë në Republikën e Kosovës, po ashtu shumë kuart në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit janë dhënë arsye ligjore mbi bazën e së cilës i është refuzuar kërkesa S. B PLC me seli në Londër, Prokuroria ka pasur kohë të mjaftueshme t'i vlerësoj provat që janë siguruar nga ana e Gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e Gjykatës janë siguruar shumë prova me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike, por edhe pse janë siguruar këto prova që vërtetojnë një gjendje faktike sidomos me pikën I të dispozitivit të aktakuzës, Prokuroria nuk ndërmarrë veprimin ligjor në mbështetje të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Andaj Gjykata në rastin konkret në raport me pikën I të dispozitivit duke vepruar në përputhje me nenin 370 par.7 të KPP-së, ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë të gjitha faktet e vërtetuara në raport me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit duke u bazuar në provat e administruara siç është Akvendimi EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017 të Gjykatës së Apelit dhe Përgjigja e dhënë nga BQK-ja datë 21.04.2016 për Gjykatën Themelore Mitrovicë, ku në këtë rast nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale Mashtrimi apo dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.2 lidhur me par.3 të KPRK-së, nga pika I e dispozitivit të Aktgjykimit, pasi që nuk përmbushen elementet e veprës penale siç konstatohet në këtë Aktgjykim.

VI.2.Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën II dhe III të dispozitivit të Aktgjykimit

VI.2.1. Pika II e dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata ka vlerësuar provat, faktet dhe rrethanat lidhur me pikën II të dispozitivit të Aktakuzës dhe ka vlerësuar se në rastin konkret është provuar se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale si në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata thekson se për tu konsideruar se është kryer një veprë penale duhet që të plotësohen elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta të asaj veprë penale, konkretisht të përmbushet figura e veprës penale. Në rastin konkret sipas pikës II të dispozitivit të Aktakuzës, i akuzuari J.S është akuzuar për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket elementeve të veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, janë dhënë arsyet ligjore si në faqen 11 të pjesës arsyetuese të këtij Aktgjykimi, respektivisht renditja VI.

Gjykata ka analizuar pikën II të dispozitivit të Aktakuzës dhe gjenë se si veprime inkriminues për të cilat është akuzuari i akuzuari J.S janë “mashtrimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. K. T. Dega në Kosovë”, ku dëmi i shkaktuar është mbi shumën 250.000€.

Gjykata gjenë se në rastin konkret përmbushen elementet e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i akuzuari J.S si në pikën II të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet kompanisë “Corsteel SH.P.K” me seli në Vushtrri dhe drejtor me autorizime të plota J.S si dhe B. K. T. Dega në Kosovë dhe atë Marrëveshjen për mbitërheqje (Oërdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, me kreditorin B. K. T. në vlerë 250.000€, si dhe Marrëveshja mbi pengun

nr.5418/13 e dt.18.04.2013, ku në këtë rast debitori “C. SH.P.K”, ka qenë i obliguar që të ruaj minimumin e pengut sipas kërkesës së kreditorit B. K. T. në shumën prej 500.000€. Po ashtu në këtë marrëveshje është specifikuar se është lënë peng kolaterali si në vijim: zink Ajax Bath:157,860 700 tons @ 1700 euro/ton, në shumë prej 268.000 euro, Warehouse Stock 178,018 tons @ 1700 euro/ton, në shumën prej 302.000 euro, metal 99.99% ZN MIN, Lme Brend i regjistruar, tarifa e kodit 7901110 me vlerë të tregut 570.000 euro.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se kanë ekzistuar raport kontraktuale juridike civile ndërmjet B. K. T. (tani e tutje BKT) dhe kompanisë C. SH.P.K sipas Marrëveshjes për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, me kreditorin B. K. T. në vlerë 250.000€, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013 si dhe debitorin C. SH.P.K ku i akuzuari J.S ka qenë drejtor me autorizime të plota.

Në Marrëveshjen për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, janë parapraë kushtet e veçanta kontraktuale ndërmjet kreditorit në këtë rast BKT dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S drejtor me autorizime të plota, po ashtu në Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, në nenin 2 të kësaj Marrëveshje është përkthuar pengun i lartcekur si në këtë Aktgjykim. Po ashtu në këto Marrëveshje është paraparë obligimi i debitorit që pengun e lartcekur t'a mbajë në depozitën e tyre deri në përmbushjen e Marrëveshjeve.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se kemi subjektet të cilat janë të parapara tek vepra penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, konkretisht kemi subjektin apo kreditorin BKT-në si dhe debitorin kompania C. SH.P.K me drejtor me autorizime të plota të akuzuarin J.S. Në këtë rast Gjykata thekson se edhe shuma për të cilën janë kontraktuar palët e tejkalon shumë mbi 250.000€.

Pra për Gjykatën nuk janë kontestuese faktet si më poshtë:

1. Ndërmjet BKT-së dhe C. SH.P.K me të akuzuarin J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, kanë ekzistuar raportet kontraktuale juridike civile sipas Marrëveshjes për mbitërheqje (Oërdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013.
2. Në rastin konkret cilësinë e kreditorit e ka pasur BKT-ja kurse cilësinë e debitorit kompania C. SH.P.K me të akuzuarin J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota.
3. Në Marrëveshjen mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, është përcaktuar pengun dhe atë kolaterali: zink Ajax Bath:157,860 700 tons @ 1700 euro/ton, në shumë prej 268.000 euro, Warehouse Stock 178,018 tons @ 1700 euro/ton, në shumën prej 302.000 euro, metal 99.99% ZN MIN, Lme Brend i regjistruar, tarifa e kodit 7901110 me vlerë të tregut 570.000 euro.
4. Në këto Marrëveshje është përcaktuar se debitori kompania C. SH.P.K, ka qenë e obliguar që të ruaj në depozitën e tyre pengun e lartcekur deri në përmbushjen e marrveshjeve.
5. Të gjitha këto Marrëveshje janë nënshkruar nga ana e të akuzuarit J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plotë për kompaninë C. SH.P.K

Për Gjykatën këto fakte nuk ishin kontestuese duke u bazuar në provat dhe atë: Marrëveshjes për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013 si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, po ashtu Aktvendimi i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 e dt.30.11.2017, andaj Gjykata faktet e lartcekura i konsideron të vërtetuara përtej dyshimit të bazuar mirë.

Mirëpo në rastin konkret ka qenë kontestuese fakti i elementeve inkriminuese në veprimet e të akuzuarit J.S si drejtor me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K në cilësinë e debitorit në

raport me kreditorin BKT-në, konkretisht elementet “mashtimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. K. T. Dega në Kosovë”.

Gjykata thekson se ashtu siç edhe ka theksuar më lart se veprimet me të cilat kryhet kjo formë e veprës penale janë të përcaktuara në par. 2 të nenit 289, ku një ndër veprimet inkriminuese është edhe ndërmarrja e ndonjë veprimi tjetër mashtrues me ç’rast dëmtohet kreditori i organizatës apo personit tjetër juridik, ashtu që kreditori vihet në atë pozitë të tillë që e zvogëlon mundësinë e realizimit të kërkesave. Po ashtu Gjykata thekson se kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se i akuzuari J.S ka qenë drejtor me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K, dhe i njëjti ka nënshkruar marrëveshjet e lartcekura dhe atë Marrëveshjen për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013 si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013. Gjykata thekson se i akuzuari ka qenë në dijeni për kushtet e marrëveshjeve të lartcekura si dhe obligimeve që rrjedhin nga këto marrëveshje konkretisht faktit se debitori ka qenë i obliguar që të ruaj në depozitën e tyre pengun e përshkruar si më lart, si garancion për kreditorin në rastin e mospërbushjes së Marrëveshjes për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013. Mirëpo në rastin konkret Gjykata bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjenë se i akuzuari J.S nuk ka vepruar në përputhje me marrëveshjet e lartcekura konkretisht në përputhje me Marrëveshjen mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013 dhe me këtë rast e ka vënë kreditorin në pozitë të atillë që e ka zvogëluar mundësinë e realizimit të kërkesave si dhe i ka shkaktuar dëm kreditorit mbi shumë 250.000€.

Fillimisht Gjykata vlerëson se në rastin konkret kreditori BKT-ja, ka vepruar në përputhje me marrëveshjet e lartcekura të cilat i kanë lidhur me debitorin kompaninë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, ashtu që në rastin kur nuk i ka përmbushur obligimet kompania C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, të njëjtit kanë vepruar për realizimin e kërkesës së tyre ku në këtë rast sipas procedurës së përmbarimit kanë tentuar që të përmbarojnë pengun e lartcekur të përshkruar si më lart. Mirëpo Gjykata thekson se edhe pse kreditori në këtë rast BKT-ja, ka vepruar sipas procedurave ligjore konkretisht sipas procedurës përmbarimore për përmbarimin e pengut, të njëjtit nuk kanë mundur që të realizojnë kërkesën e tyre për faktin se në rastin e procedurës së përmbarimit kanë hasur faktin se pengun nuk është gjetur i depozituar në depon e debitorit, konkretisht pengun është zhvendosur nga depoja e kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, ku sipas obligimit që ka rrjedhur nga Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, kanë qenë të obliguar që të njëjtin ta depozitojnë në depo. Në rastin konkret kreditorit BKT-së i është pamundësuar realizimi i kërkesës së tyre për shkak të veprimeve të ndërmarra në kundërshtim me Marrëveshjen mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, nga ana e debitorit kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota.

Fakti i lartcekur se pengun i përshkruar si në Marrëveshjen mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, nuk është gjetur i depozituar në depon e debitorit, konkretisht pengun është zhvendosur nga depoja e kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, konkretisht pengun është zhvendosur, vërtetohet edhe nga Shënimi Zyrtar i Përmbaruesit Privat D.B me numër të Lëndës P.nr.109/14 i dt.11.07.2014.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë përmbushur elementet e veprës penale Mashtimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, konkretisht në rastin konkret “mashtimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. K. T. Dega në Kosovë”. Fillimisht Gjykata vlerëson se veprimi i të akuzuari konkretisht fakti se i akuzuari e ka pasur cilësinë e drejtorit me autorizime të plota në kompaninë C. SH.P.K, dhe se i njëjti ka qenë në dijeni për kushtet e marrëveshjeve të lartcekura, ka vepruar në kundërshtim me këto

marrëveshje ashtu që ka ndërmarrë veprimin mashtrues dhe e kanë zhvendosur pengun e cekur si në Marrëveshjen mbi pengin nr.5418/13 të dt.18.04.2013, ashtu që e ka vendosur kreditorin BKT-në, në atë pozitë që e ka pamundësuar realizimin e kërkesës së tyre që ka rrjedhur nga marrëveshjet e lartcekura.

Fillimisht fakti se është zhvendosur pengu i lartcekur, e që ka qenë obligim që ky peng të depozitohet në depot e kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, përbën veprim mashtrues nga ana e të akuzuarit J.S duke pasur parasysh faktin se i njëjti ka nënshkruar marrëveshjet e lartcekura dhe se ka qenë në dijen për kushtet e marrëveshjeve, andaj me këtë rast Gjykata vlerëson se përmbushet kushti apo elementi i “mashtrimit të kreditorit” tek figura e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.2 të KPRK-së, me arsyet e tejra ligjore që konstatohen me poshte respektivisht me paragrafin 3.

Po ashtu faktin se kreditori banka BKT-ja, në momentin që nuk i janë përmbushur kushtet e Marrëveshjes për mbitërheqje (Owrdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore dhe përmes procedurës së përmbartimit ka tentuar që të përmbartoj pengun e lartcekur, mirëpo në këtë rast i është pamundësuar realizimi i një kërkesë të tillë për shkak se pengu nuk është gjetur në depon e kompanisë, është zhvendosur nga depot e kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota dhe me këtë rast kreditori është vënë në pozitën e atillë që i është pamundësuar realizimi i kërkesës së tyre që ka rrjedhur nga marrëveshjet e lartcekur ku me këtë rast i është shkaktuar dëm në shumën prej 274,588,62€. Andaj Gjykata vlerëson se në rastin konkret është përmbushur kushti apo elementi i “vendosjes së kreditorit bankës BKT-së, në atë pozitë që i është pamundësuar realizimi i kërkesës së tyre”, si element i figurës së veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.2 të KPRK-së.

Faktin se dëmi i është shkaktuar kreditorit bankës BKT-së, vërtetohet edhe nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, ku në pikën 1.3 të këtij vendimi theksohet se “APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesa e kreditorit “B. K. T.” dhe pranohet kërkesa në lartësi prej 274,588,62€.”. Pra në rastin konkret plotësohet kushti nga paragrafi 3 i nenit 289 të KPRK-së vepra penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve, pasi që dëmi i shkaktuar kreditorit bankës BKT-së ka qenë mbi shumë 250.000€.

Pra në rastin konkret kreditori B. K. T., për shkak të veprimeve mashtruese nga ana e të akuzuarit J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota të kompanisë C. SH.P.K, është vënë në pozitën e tillë ku i është pamundësuar realizimi i kërkesës së tyre si dhe i është shkaktuar dëm në cilësinë e kreditorit dhe kërkesën e saj në shumë prej 274.588,63€, ka mundur ta realizoj vetëm kur ka arritur procedura e falimentimit për kompaninë C. SH.P.K, e që ky fakt vërtetohet edhe nga Fletëpagesa me nr.00003796 e dt.08.05.2020, po ashtu fakti se i akuzuari J.S ka nënshkruar të gjitha marrëveshjet për kompaninë C. SH.P.K në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota.

Andaj në rastin konkret Gjykata vlerëson se vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 e lidhur me par.2 të KPRK-së. Gjykata në rastin konkret ka vepruar në përputhje me nenin 370 par.7 të KPP-së, ku të gjitha faktet e lartcekura i ka vërtetuar përmes provave dhe provat i ka vlerësuar dhe analizuar në raport me fuqinë provuese për faktet që kanë vërtetuar.

VI.2.2. Pika III e dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata ka vlerësuar provat, faktet dhe rrethanat lidhur me pikën III të dispozitivit të Aktakuzës dhe ka vlerësuar se në rastin konkret është provuar se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale si në pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata thekson se për tu konsideruar se është kryer një veprë penale duhet që të plotësohen elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta të asaj veprë penale, konkretisht të përmbushet figura e veprës penale. Në rastin konkret sipas pikës III të dispozitivit të Aktakuzës, i akuzuari J.S është akuzuar për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket elementeve të veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, janë dhënë arsyet ligjore si në faqen 11 të pjesës arsyetuese të këtij Aktgjykimi, respektivisht renditja VI.

Gjykata ka analizuar pikën III të dispozitivit të Aktakuzës dhe gjenë se si veprime inkriminues për të cilat është akuzuari i akuzuari J.S janë “mashtrimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. E.”, ku dëmi i shkaktuar është mbi shumën 250.000€.

Gjykata gjenë se në rastin konkret përmbushen elementet e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i akuzuari J.S si në pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet kompanisë debitorit C. SH.P.K ku J.S ka qenë në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota dhe kreditorit B. E. dhe atë Marrëveshja Kryesore Nr.109/5 e dt.26.02.2014, për financimin e debitorit Kompanisë C. Shpk, deri në shumë prej 480,000€. Po ashtu ndërmjet palëve të lartcekura është nënshkruar edhe Kontrata mbi hipotekën LRP.Nr.462/1035/2014 e dt.27.02.2014 pranë Noterit B.D, ku në nenin 3 të kësaj Kontrate ceket se “Për të siguruar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja Kryesore Nr.109/5 e arritur me dt.26.02.2014, Pronari i Palujtshmërisë së ngarkuar garanton me pasurinë e paluajtshme të cilën e lenë peng dhe në të cilën vendoset hipotek në favor të kreditorit hipotekues (është fjala për B. E.), të përshkruara si më poshtë: I. Patundshmërinë e cila evidentohet sipas çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, me numër të lëndës 19-1230 e lëshuar me dt.26.02.2014 Komuna Vushtri, Zona Kadastrale Vushtri, Zyra Kadastrale Komunale Vushtri, parcelat me numër të njësisë P-70202016-02588-1, P-70202016-02589-0, P-70202016-02590-1 dhe P-7020201602590-2, lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës pronë shoqërore, pjesa e pronës 1/1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 14292 m2, pronë e “C.” SH.P.K”. Ndërmjetë palëve të lartcekura B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K është nënshkruar Marrëveshja mbi pengun Nr.8512/85214 e dt.26.02.2014, ku në nenin 1 të kësaj Marrëveshje theksohet se “Me këtë Marrëveshje penglënësi C. SH.P.K që e përfaqëson J.S ofron si kolateral pasurinë e luajtshme – mall, paisjet sipas raportit të auditorëve Grant Thornton të dt.02.09.2013 për sigurimin e kredisë 80,000.00 euro, sipas Marrëveshjes Kreditore nr.85213/5 të dt.26.02.2014 dhe mbitërheqjes në shumë 400,000.00 me nr.85214/5 e dt.26.02.2014 si Anex i Marrëveshjes Kryesore me nr.109/5 të dt.26.02.2014” me përshkrimin: 1) Paisje sipas raportit të auditorëve G.Th të dt.02.09.2013; Vlera 25,441,300.00€ dhe 2) Mall; Vlera 825,108.00€, gjithësej vlera 26.266.408.00€. Po ashtu ndërmjetë palëve të lartcekura është nënshkruar edhe Marrëveshja kreditore për kredi Nr.85213/5 dt.26.02.2014 Anex i Marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr.109/5 ku në nenin 1 të kësaj marrëveshje përcaktohet “Banka, do t’i akordojë Huamarrësit kredinë në shumën prej 80.000.00 euro”. Po ashtu ndërmjetë palëve të lartcekura është nënshkruar edhe Marrëveshja Kreditore për Mbitërheqje me nr. 85214 e datës 26.02.2014, Anex i marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr. 109/5, ku në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje thuhet se: “Banka do t’i akordojë Huamarrësit mbitërheqjen në shumën prej 400,000.00 euro.”

Pra për Gjykatën nuk janë kontestuese faktet si më poshtë:

1. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota ka ekzistuar raport kontraktual juridiko civil dhe atë në cilësinë e kreditorit B. E. dhe në cilësinë e debitorit kompania C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota.
2. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota është nënshkruar Marrëveshja Kryesore Nr.109/5 e dt.26.02.2014, për financimin e debitorit deri në shumë prej 480,000€.
3. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota është nënshkruar Kontrata mbi hipotekën LRP.Nr.462/1035/2014 e dt.27.02.2014 pranë Noterit B.D, ku në nenin 3 të kësaj Kontrate ceket se çka është hipotekë e specifikuar si më lart në këtë Aktgjykim.
4. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota është nënshkruar Marrëveshja mbi pengun Nr.8512/85214 e dt.26.02.2014, ku në nenin 1 të kësaj Marrëveshje theksohet se çka është pengë.
5. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota është nënshkruar Marrëveshja kreditore për kredi Nr.85213/5 dt.26.02.2014 Anex i Marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr.109/5 ku në nenin 1 të kësaj marrëveshje përcaktohet shuma prej 80.000.00 euro për huamarrje.
6. Ndërmjet B. E. dhe kompanisë C. SH.P.K me J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota është nënshkruar Marrëveshja Kreditore për Mbitërheqje me nr. 85214 e datës 26.02.2014, Anex i marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr. 109/5, ku në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje përcaktohet shuma e mbitërheqjes prej 400,000.00 euro.

Faktet e lartcekura nuk janë kontestuese për Gjykatën e për më tepër vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor siç janë: Marrëveshja Kryesore Nr.109/5 e dt.26.02.2014, Kontrata mbi hipotekën LRP.Nr.462/1035/2014 e dt.27.02.2014, Marrëveshja mbi pengun Nr.8512/85214 e dt.26.02.2014, Marrëveshja kreditore për kredi Nr.85213/5 dt.26.02.2014 Anex i Marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr.109/5, Marrëveshja Kreditore për Mbitërheqje me nr. 85214 e datës 26.02.2014, Anex i marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr. 109/5, andaj Gjykata faktet e lartcekura i konsideron të vërtetuara përtej dyshimit të bazuar mirë.

Mirëpo në rastin konkret ka qenë kontestuese fakti i elementeve inkriminuese në veprimet e të akuzuarit J.S si drejtor me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K në cilësinë e debitorit në raport me kreditorin B. E., konkretisht elementet “mashtrimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. E.”.

Gjykata thekson se ashtu siç edhe ka theksuar më lart se veprimet me të cilat kryhet kjo formë e veprës penale janë të përcaktuar në par. 2 të nenit 289, ku një ndër veprimet inkriminuese është edhe ndërmarrja e ndonjë veprimi tjetër mashtrues me ç’rast dëmtohet kreditori i organizatës apo personit tjetër juridik, ashtu që kreditori vihet në atë pozitë të tillë që e zvogëlon mundësinë e realizimit të kërkesave. Po ashtu Gjykata thekson se kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje.

Në rastin konkret Gjykata vlerëson se i akuzuari J.S ka qenë drejtor me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K, dhe i njëjti ka nënshkruar marrëveshjet e lartcekura si në këtë Aktgjykim me B. E., ku për secilën marrëveshje ka qenë në dijeni për kushtet, obligimet dhe detyrimet që rrjedhin nga këto marrëveshje.

Gjykata në rasin konkret konstaton se i akuzuari J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plotë në kompaninë C. SH.P.K, ka ndërmarrë me dashje veprimet inkriminuese për veprën penale si në pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit, konkretisht i akuzuari J.S ka me dashje ka nënshkruar marrëveshjet e lartcekura me B. E. duke ndërmarrë veprimin mashtrues dhe lidhur kontratat-marrëveshje të cilat e kanë vënë kreditorin në këtë rast B. E. në pozitë të atillë që e ka pamundësuar realizimin e kërkesave si në marrëveshjet e lartcekura ashtu që i është shkaktuar dëm në shumën prej 496,434.23€.

Gjykata thekson se në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës kreditori tani pala e dëmtuar B. E. realizimin e kërkesës së saj ka mundur që t'a realizoj vetëm në procedurën e likuidimit të kompanisë C. SH.P.K. Pra në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës plotësohen elementet e figurisë së veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, siç janë elementi i mashtrimit të kreditorit B. E. përmes ndërmarrjes së veprimit mashtrues duke lidhur marrëveshjet e lartcekura dhe vendosja e kreditorit B. E. në pozitë të atillë që i është pamundësuar realizimi i të drejtave të saj që kanë rrjedhur nga marrëveshjet e lidhur me debitorin kompaninë C. SH.P.K me drejtor me autorizime të plota të akuzuarin J.S, ashtu që i është shkaktuar dëmi në shumë prej 496,434.23€ si kusht që përcaktohet nga paragrafi 3 i veprës përkatëse të lartcekur. Gjykata gjenë se i akuzuari ka qenë në dijeni për marrëveshjet e lidhur pasi që duke pasur parasysh faktin se vet i njëjti personalisht i ka nënshkruar dhe i njëjti ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të lartcekura, andaj në këtë rast Gjykata vlerëson se në bazë të fakteve dhe provave të lartcekura vërtetohet se ka ekzistuar dashja në veprimet e të akuzuarit J.S për ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese nga vepra penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Pra në rastin konkret kreditori B. E., për shkak të veprimeve mashtruese nga ana e të akuzuarit J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota të kompanisë C. SH.P.K, është vënë në pozitën e tillë ku i është pamundësuar realizimi i kërkesës së tyre si dhe i është shkaktuar dëm në cilësinë e kreditorit dhe kërkesën e saj ka mundur ta realizoj vetëm kur ka arritur procedura e likuidimit për kompaninë C. SH.P.K, e që ky fakt se i është paguar dëmi palës së dëmtuar B. E. vërtetohet edhe nga Fletëpagesa me nr.00003152 e dt.13.05.2020.

Andaj në rastin konkret Gjykata vlerëson se vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 e lidhur me par.2 të KPRK-së si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit. Gjykata në rastin konkret ka vepruar në përputhje me nenin 370 par.7 të KPP-së, ku të gjitha faktet e lartcekura i ka vërtetuar përmes provave dhe provat i ka vlerësuar dhe analizuar në raport me fuqinë provuese për faktet që kanë vërtetuar.

VI.3. Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën V të dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata gjenë se në pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës të akuzuarit J.S dhe A.J janë akuzuar për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjykata gjenë se në përshkrimin faktik të dispozitivit si në pikën IV të Aktakuzës është theksuar faktin se vepra penale dyshohet se është kryer me dt.31.12.2012.

Gjykata gjenë se në kohën kur dyshohet kryerja e veprës penale ka qenë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal UNMIK/RREG/2003/25 (KPK-ja) dhe jo Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082 – KPRK-ja) sipas të cilit të akuzuarve i është ngritur Aktakuza për veprën penale si në pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës.

Gjykata gjenë se në nenin 2 par.1 të KPK-së, përcaktohet se “Ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale”, po ashtu në nenin 3 par.1 të KPRK-së përcaktohet se “Ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës

penale”. Ndërsa në par.3 të nenit 2 të KPRK-së, përcaktohet se “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, po ashtu në par.2 të nenit 2 të KPK-së, përcaktohet se “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”.

Gjykata gjenë se për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas paragrafit 2 të këtij nenin është përcaktuar se “...kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”, kurse për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, përcaktohet se “kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet”.

Gjykata duke marrë parasysh dispozitat e lartcekura gjenë se në rastin konkret duhet vepruar sipas dispozitës së nenit 2 par.1 dhe 2 të KPK-së, pasi që koha kur dyshohet kryerja e veprës penale është data 31.12.2012, andaj në këtë rast Gjykata gjenë se është plotësuar kushti ligjor i paraparë me par.1 të nenit 2 të KPK-së, ku ndaj kryerësit të veprës penale duhet të zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, po ashtu Gjykata thekson se është plotësuar edhe kushti nga par.2 nenit 2 të KPK-së, pasi që për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dënim më i lartë është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vite kurse për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, si dënim më i lartë është paraparë dënimi me burgim deri në tri (3) vite.

Andaj Gjykata në rastin konkret bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura duke pasur parasysh faktet e lartcekura ka vepruar në përputhje me këto dispozita ligjore dhe ka rikualifikuar veprën penale nga pika IV për të cilën akuzohen të akuzuarit J.S dhe A.J dhe atë veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së në veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata pas rikualifikimit të veprës penale si në pikën V të dispozitivit të Aktgjykimit për të akuzuarit J.S dhe A.J, në veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, ka arritur në përfundimin se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut sipas nenit 90 par.1 lidhur me par.5, lidhur me nenin 91 par.6 të KPK-së.

Në nenin 90 par.1 lidhur me par.5 të KPK-së, përcaktohet se “Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:” ... “Tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim”. Po ashtu në nenin 91 par.6 të KPK-së përcaktohet se “Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”.

Gjykata gjenë se në rastin konkret vepra penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dënim maksimal për këtë vepër është paraparë dënimi me burgim deri në tri (3) vite. Në rastin konkret nga koha e kryerjes së veprës penale me dt.31.12.2012, kurse parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të akuzuarit J.S dhe A.J për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së ka arritur me dt.31.12.2018.

Faktin se vepra penale është përashkruar është cekur edhe në seancën e dt.27.01.2022, në fjalën hyrëse nga i akuzuari A.J i cili ka theksuar se koha e kryerjes së veprës penale përputhet me kohën kur ka qenë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe se dënueshmëria për këtë

vepër nga ky Kod është maksimumi 3 vite burgim andaj ka kërkuar rikualifikimin e veprës penale duke i propozuar Gjykatës që të merr aktgjykim refuzues në raport me këtë vepër penale.

Në bazë të dispozitave ligjore të konstatuar si më lart dhe fakteve të lartcekura, Gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, në raport me të akuzuarit J.S dhe A.J për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, ka marrë Aktgjykim Refuzues.

VI.4. Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën VI të dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata ka vlerësuar provat, faktet dhe rrethanat lidhur me pikën II të dispozitivit të Aktakuzës dhe ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari A.J ka kryer veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së në bashkëkryerje me të akuzuarin J.S, si në pikën VI të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata thekson se për tu konsideruar se është kryer një vepër penale duhet që të plotësohen elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta të asaj vepre penale, konkretisht të përmbushet figura e veprës penale. Në rastin konkret sipas pikës II të dispozitivit të Aktakuzës, i akuzuari A.J është akuzuar për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së në bashkëkryerje me të akuzuarin J.S.

Sa i përket elementeve të veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, janë dhënë arsyet ligjore si në faqen 11 të pjesës arsyetuese të këtij Aktgjykimi, respektivisht renditja VI.

Gjykata ka analizuar pikën II të dispozitivit të Aktakuzës dhe gjenë se si veprime inkriminues për të cilat është akuzuar, i akuzuari A.J janë “mashtrimi dhe shkaktimi i dëmit kreditorit B. K. T. Dega në Kosovë”, ku dëmi i shkaktuar është mbi shumën 250.000€.

Gjykata gjenë se në rastin konkret nuk përmbushen elementet e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i akuzuari A.J si në pikën VI të dispozitivit të Aktgjykimit.

Fillimisht Gjykata sqaron faktin se i akuzuari A.J sipas përshkrimit faktik në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës si veprime inkriminuese të ndërmarrë nga ana e të akuzuarit A.J është “... A.J ka qenë në dijeni për dëmtimin e kreditorit dhe shfrytëzimin e kolateralit të lënë peng dhe shitjen e kolateralit por nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim parandalues dhe me këtë ka kontribuar në kryerjen e veprës penale”, pra e gjitha çështja e ngritjes së Aktakuzës ndaj të akuzuarit A.J për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës ka qenë “dijenja e tij për dëmtimin e kreditorit B. K. T. dhe mos ndërmarrja e ndonjë veprimi parandalues për mos shitjen e kolateralit” dhe si rezultat i kësaj ka kontribuar në kryerjen e veprës penale si në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës.

Fillimisht Gjykata sqaron se në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.J ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se pretendimet e tilla të Prokurorisë nuk qëndrojnë, duke pasur parasysh faktet, dispozitat ligjore dhe rrethanat e theksuara si më poshtë.

Duke pasur parasysh se sipas pikës II të dispozitivit të Aktakuzës i akuzuari A.J është akuzuar se në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPRK-së me të akuzuarin J.S kanë kryer veprën penale

Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, konkretisht si palë e dëmtuar BKT-ja.

Gjykata sqaron se në nenin 31 të KPRK-së përcaktohet Bashkëkryerja si në vijim “*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.*”

Gjykata sqaron faktin se për t'u konsideruar se ekziston bashkëpunimi tek Bashkëkryerja, midis pjesëmarrësve duhet të shprehet lidhja e caktuar objektive dhe subjektive. Pra duhet të shprehet lidhja objektive që secili bashkëpunëtor duhet të ndërmarrë ndonjë veprim me të cilin i kontribuon kryerjes së veprës penale, veprimet duhet të jenë të lidhura midis tyre dhe të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjtë, që të shkaktohet pasoja e caktuar. Kurse tek lidhja subjektive të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

Në rastin konkret Gjykata gjenë se nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e lartcekura të bashkëkryerjes për të akuzuarin A.J për veprën penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Fillimisht Gjykata sqaron se janë fakte të pakontestueshme se ndërmjet kompanisë C. SH.P.K me të akuzuarin J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota dhe B. K. T. (tani e tutje BKT-ja) kanë ekzistuar raporte kontraktuale që kanë dalur nga Marrëveshja për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013.

Po ashtu fakte të pakontestueshme janë edhe se i akuzuari A.J ka qenë i punësuar në kompaninë C. SH.P.K, ku i akuzuari J.S ka pasur cilësinë e drejtorit me autorizime të plota e që ky fakt vërtetohet edhe nga provat siç janë Kontrata e punës me nr.138 e dt.01.01.2013 si dhe Ankesë kontrata e punës e lidhur ndërmjet kompanisë C. SH.P.K dhe punërmarrësit A.J.

Gjykata sqaron faktin se të dy këto Marrëveshje janë nënshkruar nga i akuzuari J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota për kompaninë C. SH.P.K, mirëpo Gjykata e thekson faktin se në asnjërin nga këto Marrëveshje të nënshkruara nuk figuron nënshkrimi i të akuzuarit A.J, madje as që përmendet ndokund në këto Marrëveshje emri i të akuzuarit A.J.

Gjykata duke marrë parasysh se në rastin konkret sipas përshkrimit të Prokurorisë në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës është theksuar vetëm fakti se i akuzuari A.J ka qenë në dijeni për Marrëveshjet e lidhura nga i akuzuari J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plotë për kompaninë C. SH.P.K me Bankën BKT-në, ka qenë në dijeni se është shitur kolaterali i lënë peng e po ashtu se nuk ka ndërmarrë veprime parandaluese për mos shitjen kolateralit.

Fillimisht Gjykata sqaron se elementi i “dijenisë” nga i akuzuari A.J për faktet e lartcekura se është lidhur Marrëveshja me Bankën BKT-në, po ashtu se është shitur kolaterali, nuk hynë në kuadër të elementeve të Bashkëkryerjes nga neni 31 i KPRK-së, për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës. Andaj Gjykata sipas vlerësimit të saj thekson se nuk qëndron fakti se “Dijenia” në rastin konkret është element i Bashkëkryerjes dhe si i tillë nuk mund të qëndroj si veprim inkriminues i të akuzuarit A.J me të cilin ka kontribuar në kryerjen e veprës penale. Pra në këtë rast sipas vlerësimit të Gjykatës nuk ekziston lidhja objektive tek Bashkëkryerja pasi që i akuzuari nuk ka ndërmarrë ndonjë veprime inkriminues me të cilin ka kontribuar në kryerjen e veprës penale nga pika II e dispozitivit të Aktakuzës, pasi që “Dijena” nuk hynë në rastin konkret si element i Bashkëkryerjes.

Po ashtu Gjykata sqaron se “elementi i mos ndërmarrjes së ndonjë veprimi parandalues” nga i akuzuari A.J, po ashtu nuk mund të qëndroj si element i Bashkëkryerjes nga neni 31 i KPRK-së, lidhur me veprën penale nga pika II e dispozitivit të Aktakuzës për të cilën akuzohet i akuzuari A.J. Gjykata sqaron se në rastin konkret nuk ekzistojnë element, konkretisht nuk mund të themi se ka lidhje objektive ndërmjet elementit “mos ndërmarrje e veprimeve parandaluese” dhe dashjes së të akuzuarit konkretisht qëllimit në kontribuimin e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret Gjykata thekson se mund të thirremi në ndonjë vepër të veçantë në kuadër të veprave penale të përcaktuara në Kodin Penal mirëpo jo në element të bashkëkryerjes të futet edhe “mos ndërmarrja e veprimit parandalues”.

Sa i përket lidhjes subjektive e cila duhet të ekzistojë tek Bashkëkryerja, Gjykata gjenë se në rastin konkret duke pasur parasysh se nuk është përmbushur elementi konkretisht lidhja objektive tek bashkëkryerja atëherë në rastin konkret nuk mund të thirremi fare në elementin e lidhjes subjektive, pasi që kushtet tek bashkëkryerja konkretisht lidhja objektive dhe subjektive duhet përmbushur komulativisht. Për më tepër Gjykata thekson se në bazë të provave dhe fakteve të lartcekura nuk ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit A.J ka qëndruar elementi se në kryerjen e veprës penale dhe shkaktimit të pasojës do të veprojnë në ndonjë mënyrë të caktuar.

Andaj mbi këtë bazë Gjykata gjenë se rastin konkret nuk ekziston lidhje objektive në veprimet e të akuzuarit A.J në raport me bashkëkryerjen për veprën penale për të cilën akuzohet sipas pikës II të dispozitivit të Aktakuzës, pasi që mungon veprimi inkriminues për kontribuimin në kryerjen e vepërs penale konkretisht “dijeni” dhe “mos ndërmarrja e veprimeve parandaluese” sipas vlerësimit të Gjykatës nuk hyjnë në kuadër të elementeve të bashkëkryerja, e po ashtu faktit se nuk plotësohet edhe kushti tjetër i bashkëkryerjes lidhja subjektive në raport me të akuzuarin A.J pasi që në veprimet e të akuzuarit nuk ka qëndruar fakti i vetëdijes se do të ndërmarrë veprime të caktuara inkriminuese me qëllimin që të kryhet vepra penale dhe të shkaktohet pasoja siç është akuzuar në pikën II të dispozitivit të Aktakuzës.

Gjykata thekson se në bazë të nenit 241 par.1 nën par.1.7 të KPP-së, theksohet obligimi i Prokurorisë që me rastin e ngritjes së aktakuzës të jep shpjegime për arsyet e ngritjes së aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provave që vërtetojnë faktet kryesore. Gjykata gjenë se në rastin konkret Prokuroria nuk e ka përmbushur kushtin ligjor që rrjedh nga ky nen pasi që mungojnë arsyet kryesore lidhur me faktet kryesor, bazuar në provat ligjore për shpjegimin mbi ngritjen e aktakuzës për të akuzuarin A.J në raport me veprën penale si në pikën II të Aktakuzës. Fillimisht Gjykata sqaron se në arsyetimin e Aktakuzës të gjitha faktet e cekura për veprimet inkriminuese në raport me veprën penale për të akuzuarin A.J mbështeten në deklaratën e të akuzuarit A.J dhe kontratën e punës së bashku me aneksë kontratën e punës për të akuzuarin A.J në kompaninë C. SH.P.K. Gjykata sqaron se arsyetimi i tillë i fakteve nga ana e Prokurorisë krijojnë një pasiguri juridike në raport me vërtetimin e këtyre fakteve, pasi që nuk është e mjaftueshme gjithnjë sipas vlerësimit të Gjykatës që faktet kryesore që duhet vërtetuar në raport me çështjen konkrete lidhur me vërtetimin përtej dyshimit të bazuar mirë se është kryer vepra penale apo faktit se nuk provohet kryerja e veprës penale, të lihen në mënyrë të tillë të pavërtetuara në bazë të provave konkrete dhe vetëm që të lihet fakti i tillë sipërfaqësisht i përshkruar pa ndonjë prova që bazohet në të. Andaj mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se Prokuroria në rastin konkret nuk ka vepruar në bazë të obligimeve ligjore që rrjedhin nga neni 241 par.1 nën par.1.7 të KPP-së.

Andaj Gjykata në bazë të fakteve, rrethanave dhe provave të lartcekura të administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor, e të sqaruara në këtë Aktgjykim gjenë se në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve nga neni 289 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, konkretisht nuk përmbushet edhe elementi i bashkëkryerjes në kuadër të veprës penale. Andaj Gjykata duke vepruar në bazë të nenit 370 par.7 të KPP-së, duke artikuluar të gjitha faktet e

bazuar në prova, në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, ka marrë Aktgjykim lirues në raport me të akuzuarin A.J pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet si pikën II të dispozitivit të Aktakuzës konkretisht sipas pikës VI të dispozitivit të Aktgjykimit.

VI.5. Gjetjet e Gjykatës në raport me pikën VII të dispozitivit të Aktgjykimit

Gjykata ka vlerësuar provat, faktet dhe rrethanat lidhur me pikën V të dispozitivit të Aktakuzës dhe ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është provuar se të akuzuarit N.K dhe I.Z kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në pikën VII të dispozitivit të Aktgjykimit.

Gjykata thekson se për tu konsideruar se është kryer një veprë penale duhet që të plotësohen elementet e përgjithshme dhe elementet e veçanta të asaj veprë penale, konkretisht të përmbushet figura e veprës penale. Në rastin konkret sipas pikës V të dispozitivit të Aktakuzës, të akuzuarit N.K dhe I.Z janë akuzuar për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, Gjykata thekson se kjo vepra penale ekziston kur personi zyrtar a personi përgjegjës, duke shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij, ose duke mos i kryer detyrat e veta zyrtare, përfiton për vete a për tjetrin “ose organizatën e biznesit” çfarëdo dobie, i shkakton dëm tjetrit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, kurse si veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mospërmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare).

Gjykata thekson se:

- Shfrytëzimi i detyrës zyrtare apo i autorizimeve ekziston kur personi zyrtar ndërmerr veprime të cilat formalisht janë në kuadër të autorizimeve të tij, por janë të kundërligjshme në aspektin material, ngase janë në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit.
- Tejkalimi i autorizimeve zyrtare ekziston kur personi zyrtar vepron jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tij reale, kryesi i veprës penale tejkalon kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare, ngase ndërmerr veprime zyrtare që cilat janë në kompetencë të një personi tjetër zyrtar (të një instance më të lart; a më të ulët), ose që i përket një shërbimi krejtësisht tjetër (i ashtuquajtur i uzurpim).
- Moskryerja e detyrës zyrtare ekziston kur personi zyrtar nuk e kryen detyrën zyrtare, nuk ndërmerr veprimin zyrtar që është i detyruar ta ndërmarrë, ose kur këtë veprimin e bën të tillë që të mos mund të arrihet qëllimi, i cili do të realizohej, po ta ndërmernte atë veprim (kryerja formale ose lëshimi material i detyrës zyrtare); personi zyrtar nuk e bën atë që u përket kompetencave të tij e që është i detyruar ta bëjë; ai refuzon ta kryejë atë që është i detyruar ta kryejë, ose zvarrit ndërmarrjen a kryerjen e ndonjë detyrimi të tij zyrtar.

Gjykata gjenë se në përshkrimin faktik të pikës V të dispozitivit të Aktakuzës të akuzuarit N.K dhe I.Z akuzohen se kanë ndërmarrë tri veprimet e kryerjes së kësaj veprë penale si veprime inkriminuese pra kanë shfrytëzuar detyrën zyrtare, kanë tejkaluar kompetencat e tyre dhe po ashtu nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, me qëllimin që i akuzuari J.S si drejtori me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K, të përfitojë dobi.

Gjykata thekson se sipas përshkrimit faktik të pikës V të dispozitivit të Aktakuzës të akuzuarit theksohet se edhe pse kanë qenë të obliguar sipas ligjit që të kontrollojnë dhe verifikojnë dokumentet e nevojshme se a plotësohen kushtet për lirim të hipotekës së kredimarrësit C.

SH.P.K, se a i ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj kredithënësit S. B PLC me seli në Londër, këtë nuk e kanë bërë dhe i akuzuari N.K ka nënshkruar aktvendimin mbi lirimin (shuarjen) e hipotekës, kurse i akuzuari I.Z ka përpiluar aktvendimin e cekur mbi lirimin (shuarjen) e hipotekës, pa i përmbushur obligimet kredimarrësi i akuzuari J.S si drejtor me autorizime të plota i kompanisë C. SH.P.K ndaj kreditorit S. B PLC me seli në Londër, këtë e kanë bërë sipas autorizimit dhe kërkesës së datës 10.01.2013 që ka qenë e pavulosur nga ana e S. Bës me seli në Londër kurse me vulë Zyra e përkthimeve Aulona pa adresë dhe i pa nënshkruar.

Fillimisht Gjykata do të ndërlidhet tek elementi i tejkalimit të autorizimit – kompetencave si element i cekur në përshkrimin e pikës V të dispozitivit të Aktakuzës, pasi që të akuzuarit N.K dhe I.Z, akuzohen për tejkalimin e kompetencave të tyre, edhe pse për piken I të dispozitivit të aktakuzës është liruar i akuzuari J.S, pasi që nuk është vërtetuar se i akuzuari J.S ka kryer veprën penale Mashtrimi ose demtim i kreditorëve apo debitorëve nga eni289 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-es. në mungesë të provave materiale, kjo duke u mbështetur edhe në arsyet ligjore të konstatuara në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Gjykata si më lart në këtë pikë të Aktgjykimit ka dhënë sqarimin e saj se çka nënkupton tejkalimi i autorizimit – kompetencës dhe në rastin konkret Gjykata bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk mundi të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë tejkaluar autorizimet – kompetencat e tyre. Gjykata bazuar në faktin se i akuzuari N.K ka qenë Drejtor për gjeodezi dhe kadastër në Komunën e Vushtrrisë dhe se i akuzuari I.Z ka pasur pozitën e përgjegjës të sektorit në kadastër në Komunën e Vushtrrisë, gjenë se pikërisht për këto fakte nuk mund të vërtetohet se të akuzuarit kanë kaluar kompetencat – autorizimet e tyre.

Gjykata bazuar në faktin se i akuzuari N.K ka pasur pozitën zyrtare të Drejtorit në Drejtorinë për gjeodezi dhe kadastër në Komunën e Vushtrrisë, gjenë se është në kuadër të detyrave dhe autorizimeve të tyre konkretisht në kompetencën e drejtorit dhe drejtorisë që të bëjë regjistrimin e shuarjen e hipotekave në kuadër të komunës përkatëse, konkretisht në Komunën e Vushtrrisë. Po ashtu i akuzuari I.Z ka pasur pozitën zyrtare dhe atë përgjegjës i sektorit në kadastër në Komunën e Vushtrrisë dhe detyra e regjistrimit dhe shuarjes së hipotekave hynë pikërisht në kuadër të autorizimeve dhe kompetencat e tijë konkretisht në kompetencat e drejtorisë për kadastër. Pra në rastin konkret Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarve nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar se kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale dhe atë të “tejkalimit të kompetencës së tyre”, pasi që të dy të akuzuarit kanë vepruar në kuadër të detyrave dhe kompetencave të tyre si persona zyrtar dhe kanë bërë regjistrimin dhe shuarjen e hipotekave që kanë hyrë në kuadër të zonës kadastrale të Komunës së Vushtrrisë, e që bazuar në përshkrimin faktik të pikës V të dispozitivit të Aktakuzës ku theksohet se “Si persona zyrtar i pandehuri N.K – drejtor i drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër ndërsa i pandehuri I.Z – përgjegjës i sektorit në kadastër në komunën e Vushtrrisë ...”, pikërisht ky përshkrim i tillë bie në kundërshtim direkt me faktin e pretenduar të Prokurorisë se të akuzuarit “kanë tejkaluar kompetencat e tyre”. Andaj mbi këtë bazë me arsyet e cekura si më lart Gjykata gjenë se në rastin konkret nuk qëndron pretendimi i Prokurorisë si në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës së të akuzuarit kanë “tejkaluar kompetencat e tyre”.

Së dyti Gjykata ndërlidhet tek elementi i moskryerjes së detyrës zyrtare – mospërmbushja e detyrës si element i cekur në përshkrimin e pikës V të dispozitivit të Aktakuzës, pasi që të akuzuarit N.K dhe I.Z, akuzohen se “nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare”.

Gjykata gjenë se në rastin konkret duke pasur parasysh provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe faktet e çështjes të përshkruara në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës, nuk

mund të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale për të cilin akuzohen duke “mos përmbushur detyrën zyrtare”.

Gjykata bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjenë se në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se të akuzuarit kanë bërë regjistrimin dhe shuarjen e hipotekës në raport me kreditorin S. B PLC me seli në Londër si dhe debitorin kompaninë C. SH.P.K me drejtor me autorizime të plota të akuzuarin J.S.

Pra në rastin konkret ashtu edhe siç është përshkruar në përshkrimin faktik në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës, Gjykata gjenë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimet në kuadër të kompetencave të tyre me rastin e regjistrimit dhe shuarjes së hipotekës për hipotekat e theksuar si në përshkrimin faktik, e po ashtu faktik se këto veprime (regjistrimi dhe shuarja e hipotekave) kanë qenë në kuadër të autorizimeve të tyra Gjykata ka theksuar më lart në këtë Aktgjykim se janë në përputhje me detyrat, kompetencat – autorizimet e drejtorit të drejtorisë dhe përgjegjësit të sektorit.

Në rastin konkret Gjykata gjenë se vet përshkrimi i dispozitivit të Aktakuzës është në kundërshtim të plotë me faktin se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes “mospërmbushja e detyrës zyrtare” pasi që në tërë përshkrimin faktik të pikës V të dispozitivit të Aktakuzës është theksuar fakti se të akuzuarit kanë vepruar pra kanë bërë regjistrimin dhe shuarjen e hipotekave. Andaj mbi këtë bazë me arsyet e cekura si më lart Gjykata gjenë se në rastin konkret nuk qëndron pretendimi i Prokurorisë si në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës së të akuzuarit “nuk kanë përmbush detyrën zyrtare”.

Së treti Gjykata ndërlidhet tek elementi i shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar si element i cekur në përshkrimin e pikës V të dispozitivit të Aktakuzës, pasi që të akuzuarit N.K dhe I.Z, akuzohen se “duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tyre zyrtar kanë tejkaluar kompetencat e tyre”.

Gjykata si më lart në këtë Aktgjykim ka dhënë sqarimin e saj se çka nënkupton shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar dhe në rastin konkret ka gjetur se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë këtë veprim të kryerjes së veprës penale. Për më tepër Gjykata gjenë se përshkrimi i tillë siç është theksuar nga ana e Prokurorisë është tejetë i paqartë në raport me atë se çka ka dashur që të vërtetohet Prokuroria “shfrytëzimin e detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar” apo “tejkalimin e kompetencave” pasi që në rastin konkret sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund të qëndroj pretendimi i tillë konkretisht konstatimi i tillë që të akuzuarit duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar kanë bërë tjekealim të kompetencave, pasi që një konstatim i tillë është në kundërtënjë të drejtëpërdrejtë me veten, pasi që këto dy veprime të kryerjes janë krejtësisht të kundërta andaj sipas vlerësimit të Gjykatës nuk mund të kemi tjekealim të kompetencës duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar.

Përkundër konstatimeve si më lart, Gjykata prapë do të bëjë sqarimin e saj në raport me faktin se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale dhe atë “shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar”. Gjykata sqaron se duke analizuar në tërësi Aktakuzën konkretisht pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës si dhe pikën I po ashtu pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit, gjenë se Aktuza ka kundërtënjë mes vete dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, konkretisht pika IV e dispozitivit të Aktakuzës është në kundërtënjë të plotë me pikën V të Aktakuzës dhe gjetjet e Gjykatës në raport me pikën I si në këtë Aktgjykim.

Fillimisht Gjykata në pikën VI.1, duke u bazuar në provat konkrete që janë sqaruar në këtë pikë siç është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, ka arritur në

përfundimin se nuk është kryer vepra penale nga i akuzuari J.S ashtu siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit të Aktakuzës, për faktin se S. B PLC me seli në Londër nuk e ka pasur far statusin e kreditorit në raport me Kompaninë C. SH.P.K me drejtor me autorizime të plotë të akuzuarin J.S. Pra në rastin konkret të gjitha Marrëveshjet që janë lidhur mes S. B PLC me seli në Londër dhe kompanisë C. SH.P.K, që kanë pasur të bëjnë me kredin apo edhe mbi regjistrimin e hipotekave nuk kanë qëndruar si të tilla dhe me këtë rast nuk i është njohur e drejta e kreditorit S. B PLC me seli në Londër si dhe e drejta e kërkesës monetare në bazë të Aktvendimit i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017. Pra në rastin konkret edhe Aktvendimet mbi lirimin dhe shuarjen e hipotekës në raport me S. B PLC me seli në Londër nuk kanë pasur ndonjë efekt konkretisht të gjitha këto vendime do të jenë “nule” në raport me faktet që janë konstatuar në to.

Po ashtu Gjykata gjenë se në pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës të akuzuarit J.S dhe A.J janë akuzuar për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe pikërisht për dokumentet që kanë të bëjnë me ç’regjistrimin e hipotekës për S. B PLC me seli në Londër, e të cilat dokumente janë dorëzuar në Komunën e Vushtrrisë në drejtorin për kadastër dhe gjeodezi për ç’regjistrimin e hipotekës. Gjykata në raport me të akuzuarit J.S dhe A.J si në pikën V të Aktgjykimit është fakt që ka marrë Aktgjykim Refuzues për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, mirëpo Gjykata në rastin konkret ndërlidhet me faktin se pikërisht në dy pika të ndryshme të Aktakuzës janë përshkruar fakte-veprime të cilat bien në kundërtësi direkte mes vete siç është pika IV dhe pika V e dispozitivit të Aktakuzës. Pra bazuar në këtë fakt Gjykata gjenë se të akuzuarit N.K dhe I.Z në rastin konkret sipas përshkrimit në Aktakuzën e Prokurorisë kanë vepruar dhe kanë nxjerr vendimet mbi lirimin e hipotekës në bazë të dokumenteve të falsifikuara të cilat janë prezentuar tek ta. Andaj Gjykata vlerëson se në rastin konkret Prokuroria nuk ka ofruar prova konkrete dhe bindëse për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit N.K dhe I.Z kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen si në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës, pasi që pikërisht përshkrimi i Aktakuzës bie në kundërshtim me veten e saj.

Po ashtu Gjykata në bazë të vlerësimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor po ashtu në bazë të fakteve të lartcekura nuk ka arritur që të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se qëllimi i të akuzuarve N.K dhe I.Z ka qenë “që të përfitoj dobi i akuzuari J.S”, e për më tepër këtë fakt Prokuroria e ka lënë vetëm të përshkruar në pikën V të dispozitivit të Aktakuzës dhe se nuk ka ofruar asnjë edhe një provë të vetme që të vërtetojë këtë fakt, e për më tepër as në arsyetimin e Aktakuzës nuk e ka dhënë as edhe një sqarim të vetëm se ku e ka bazuar nje pretendim te tille. Andaj mbi këtë bazë dhe fakteve të lartcekura Gjykata nuk arriti të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit N.K dhe I.Z kanë pasur qëllim që i akuzuari J.S të përfitoj ndonjë dobi.

Mbi këtë bazë Gjykata bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor siç është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, me anë të së cilit S. B PLC me seli në Londër fare nuk i është njohur e drejta e kreditorit në raport me kompaninë C. SH.P.K ku i akuzuari J.S ka qenë drejtor me autorizime të plota, po ashtu faktit se në pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës Prokuroria ka bërë një përshkrim të atillë të fakteve ku ka theksuar se të gjitha dokumentet që kanë pasur të bëjnë me ç’regjistrimin e hipotekës kanë qenë të falsifikuara dhe të njëjtat i janë prezentuar të akuzuarve N.K dhe I.Z, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Prokuroria ka bërë përshkrimin e fakteve në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor po ashtu në raport faktet të cilat kanë mbetur në mëdyshje dhe ashtu siç përcakton neni 3 i KPP-së, se të gjitha mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen zbatohen në favor të akuzuarit, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin konkret nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit N.K dhe I.Z kanë ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale “duke shfrytëzuar

detyrën apo autoritetin zyrtar” në raport me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke marrë parasysh se në raport me të akuzuarit N.K dhe I.Z nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, nuk është lëshuar në vërtetimin e elementit të bashkëkryerjes pasi që në rastin konkret nuk mund të thirremi në elementin e bashkëkryerjes në raport me gjetjet e Gjykatës si në pikën VII të dispozitivit të Aktgjykimit, ku Gjykata ka marrë Aktgjykim Lirues për të akuzuarit bazuar në nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

VII. Vlerësimi i provave të administruara dhe deklarimeve të dëshmitarëve

Gjykata në pikën IV si në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ka bërë përshkrimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat janë propozuar nga ana e Prokurorisë po ashtu provat të cilat Gjykata i ka marrë sipas detyrës zyrtare me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike. Gjykata thekson se ka bërë vlerësimin e të gjitha provave bazuar në nenin 370 par.1 të KPP-së dhe faktet që kanë vërtetuar këto prova.

Fillimisht Gjykata sqaron se të gjitha provat që ndërlidhen në raport me faktet rreth ekzistimit të veprës penale nga pika I e dispozitivit të Aktgjykimit e që kanë të bëjnë me raportet kontraktuale (siç janë marrëveshjet për kredi, regjistrimi dhe ç’regjistrimi i hipotekës, dëmi i shkaktuar me qëllim që të mos përshkruhen parpë të njëjtat) në mes S. B PLC me seli në Londër dhe kompanisë C. SH.P.K me të akuzuarin J.S në cilësinë e drejtorit me autorizime të plota, bien në kundërthënje direkte me provën e marrë nga Gjykata dhe atë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, ku në këtë Aktvendim S. B PLC me seli në Londër nuk i është njohur e drejta e kreditorit në raport me kompaninë C. SH.P.K. Andaj mbi këtë bazë Gjykata vlerëson se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, është prova kryesor që vërteton të gjeturat e Gjykatës në raport me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit dhe mbi këtë bazë i fal vlerësimin e plotë në raport me fuqin provuese që ka si provë në raport me faktet që vërteton. Po ashtu Gjykata këtë fakt e bazon edhe në provën tjetër e që është Përgjigja e dhënë nga BQK-ja për Gjykatën Themelore në Mitrovicë me dt.21.04.2016, ku theksohet fakti se S. B PLC me seli në Londër nuk ka pasur të drejtën ligjore për operimin e kredive komerciale në Republikën e Kosovës, andaj mbi këtë bazë Gjykata i fal besimin e plotë në raport me fuqin provuese kësaj prove dhe se e njëjta nuk është në kundërthënje me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Sa i përket provave të tjera siç janë Marrëveshja për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013 me kreditorin B. K. T. në vlerë 250.000€, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013 si dhe debitorin C. SH.P.K ku i akuzuari J.S ka qenë drejtor me autorizime të plota, Gjykata gjenë se këto dy prova janë në përputhje të plotë me provat e tjera konkretisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, si dhe gjetjet e Gjykatës në raport me pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit, pasi që është vërtetuar se kreditori BKT-ja, është vënë në pozitë të atillë që nuk ka mundur që të realizoj kërkesat e saj që kanë rrjedhur nga këto marrëveshje dhe se i është njohur e drejta në kërkesën pasurore juridike e cekur në pikën 1.3 të dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017 si dëm i shkaktuar pasuror të cilën shumë e kanë realizuar në procedurën e falimentimi të kompanisë C. SH.P.K. Po ashtu Gjykata thekson faktin se këto prova i ka vlerësuar edhe në raport me fuqin provuese për pikën VI të dispozitivit në raport me aktgjykimin lirues për të akuzuarin A.J dhe Gjykata thekson se në bazë të arsyetimit të fakteve që i ka dhënë si në pikën VI.4 në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, të njëjtat prova vërtetojnë faktet kryesor të arsyetuar dhe atë se askund në këto marrëveshje nuk përmendet emri i të akuzuarit A.J dhe se i njëjti nuk e ka nënshkruar asnjërin nga këto marrëveshje, andaj mbi këto

aryse Gjykata i ka falur besimin e plotë këtyre provave në raport me fuqin provuese që kanë për aktgjykimin lirues për të akuzuarin A.J.

Sa i përket provës Shënimit zyrtar të përmbartjes privat D.B P.nr.109/14 i dt.11.07.2014, Gjykata gjenë se kjo provë është në përputhje me gjetjet e Gjykatës si në pikën VI.2 të arsyetimit të Aktgjykimit, si dhe provat e tjera siç janë Marrëveshja për mbitërheqje (Overdraft/OVD) nr.5418/13 e dt.18.04.2013 me kreditorin B. K. T. në vlerë 250.000€, si dhe Marrëveshja mbi pengun nr.5418/13 e dt.18.04.2013, ku vërtetohet se kreditori në këtë rast pala e dëmtuar BKT-ja është vënë në pozitë të atillë që nuk ka mundur të realizoj të drejtat e saj nga Marrëveshjet e lartcekura, pasi që pengu është zhvendosur nga depoja e debitorit kompanisë C. SH.P.K me drejtor me autorizime të plota J.Sn, andaj mbi këto gjetje të Gjykatës dhe faktet e lartcekura, Gjykata kësaj prove i ka falur besimin e plotë me faktet që ka vërtetuar.

Sa i përket provave që ndërlidhen me kreditorin – palën e dëmtuar B. E. e që janë: Marrëveshja Kryesore Nr.109/5 e dt.26.02.2014, Kontrata mbi hipotekën LRP.Nr.462/1035/2014 e dt.27.02.2014 pranë Noterit B.D, Marrëveshja mbi pengun Nr.8512/85214 e dt.26.02.2014, Marrëveshja kreditore për kredi Nr.85213/5 dt.26.02.2014 Anex i Marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr.109/5, Marrëveshja Kreditore për Mbitërheqje me nr. 85214 e datës 26.02.2014, Anex i marrëveshjes kryesore të produkteve kreditore për biznes nr. 109/5, Gjykata i ka falur besimin e plotë në raport me fuqin provuese për faktet që kanë vërtetuar si në pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit, pasi që edhe në rastin konkret është vërtetuar dëmi i shkaktuar debitorit B. E. dhe fakti se debitori në këtë rast është vendosur në pozitë të atillë që i është pamundësuar realizimi i të drejtave të tyre deri në procedurën e likuidimi të kompanisë C. SH.P.K siç është theksuar në këtë Aktgjykim.

Gjykata në raport me provat siç janë Autorizimi për ç’regjistrimin e hipotekës në emër të S. B PLC me seli në Londër, Kërkesën për ç’regjistrim të hipotekës dhe Raporti i ekspertimit nga AKF-ja, nr.AKF/2016-1693/2016-1422 e dt.17.08.2016, Gjykata duke marrë parasysh faktin se në raport me pikën V të dispozitivit të Aktgjykimit, ka marrë Aktgjykim refuzues për të akuzuarit, Gjykata nuk është lëshuar në raport me vërtetimin e fakteve dhe fuqisë provuese që kanë këto prova, andaj mbi këtë bazë Gjykata ka vepruar në mënyrë të tillë në raport me këto prova.

Sa i përket Aktvendimit mbi lirimin e hipotekës me nr.01/13 i dt.10.01.2013 si dhe Aktvendimit mbi regjistrimin e hipotekës nr.13/2014 i dt.28.02.2014 si dhe të gjitha provat e tjera që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe shuarjen e hipotekës (Formulari për regjistrimin e hipotekës ...), Gjykata siç edhe ka vlerësuar në bazë të gjetjeve të saj në pikën VI.5 në arsyetimin e Aktgjykimit, gjenë se provat e lartcekura nuk kanë ndonjë fuqi provuese në raport me veprën penale për të cilën akuzohen të akuzuarit N.K dhe I.Z nga pika V e Aktakuzës, pasi që këto prova bien në kundërtënie direkte me provën tjetër dhe atë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017, ku është theksuar fakti se S. B PLC me seli në Londër në këtë rast nuk ka mundur fare që të operoj në Republikën e Kosovës në raport me operacionet financiare për kredi komerciale dhe mbi këtë bazë nuk i është lejuar e drejta e regjistrimit të hipotekës, andaj bazuar në këto fakte Gjykata nuk i fal besimin provave të lartcekura pasi që të njëjtat bien në kundërtënie direkte me provat e tjera dhe atë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017.

Gjykata në raport me provën Ekspertizën Financiare Nr.060/2017 e dt.12.07.2017 e kryer nga eksperti financiar Dr.sc.V.I, Gjykata gjenë se në këtë ekspertizë në pikën 18 dhe 19 të saj nuk është që është dhënë ndonjë përfundim i kuart i cili do t’i shërbente Gjykatës në raport me vërtetimin e ndonjë fakti, për më tepër Gjykata vlerëson se ekspertiza e kryer në raport me çështjet-pyetjet e ngritura nga ana e Gjykatës përmbanë çështje të lëna “pezull” dhe jo të sqaruar si duhet nga ana e ekspertit në fjalë, andaj mbi këto fakte Gjykata nuk ka arritur në

ndonjë përfundim se çfarë fuqie provuese mund të ketë një eksperimente e tillë financiare e cila vetëm ka lënë çështjet “pezull” duke dhënë një përshkrim të përgjithshëm të fakteve notore.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve T. M. A dhe Sh.J të dhëna në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.15.03.2016, Gjykata gjenë se deklarata e dëshmitares T. M. A nuk është që e inkriminon ndonjërinë nga të akuzuarit në ndonjë mënyrë në raport me veprimet inkriminues drejtë figurës së veprës penale, Gjykata vlerëson se dëshmitarja në fjalë më shumë ka bërë përshkrimin e fakteve që nuk kanë pasur ndonjë ndërlidhje relevante me faktet konkrete të çështjes për të cilat janë akuzuar të akuzuarit, andaj mbi këtë bazë Gjykata nuk është që ka vërtetuar ndonjë fakt relevant të çështjes lidhur me deklaratimet e dëshmitares T. M. A dhe si të tillë deklaratës së dëshmitares nuk i jep ndonjë fuqi provuese direkte në raport me faktet kryesore të çështjes. Sa i përket deklaratave të dëshmitarit Sh.J, Gjykata gjenë se dëshmitari në fjalë ka dëshmuar lidhur me disa fakte për çështjen e ngritur nga Prokuroria si në pikën IV të dispozitivit të Aktakuzës ku të akuzuarit J.S dhe A.J janë akuzuar për veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së e rikualifikuar nga ana e Gjykatës në veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 23 të KPK-së me arsyetimin si në pikën VI.3 të arsyetimit të këtij Aktgjykimi, për të cilën veprën penale Gjykata në raport me të akuzuarit ka marrë Aktgjykim refuzues, andaj duke pasur parasysh këtë fakt, Gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarit Sh.J duke pasur parasysh faktin se i njëjti më shumë në deklaratën e tij ka dëshmuar për fakte inkriminuese nga pika IV e dispozitivit të Aktakuzës.

Gjykata thekson se ka bërë vlerësimin e të gjitha provave bazuar në nenin 370 par.1 të KPP-së dhe faktet që kanë vërtetuar këto prova, andaj mbi faktet dhe gjetjet e Gjykatës në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata ka bërë vlerësimin e provave si në pikën VII të këtij Aktgjykimi.

VIII. Korigjimi dhe plotësim i dispozitivit të akuzës në përshkrimin faktik në bazë të gjendjes faktike

Në dispozitivin e Aktakuzës është bërë përshkrimi faktik si nën pikën I, II, III, IV dhe V të veprave penale për të cilat të akuzuarit janë akuzuar ku në përshkrimin faktik të dispozitivit të Aktakuzës ka pasur të meta në raport përshkrimin e dispozitivit edhe në bazë të provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se përshkrimi i dispozitivit të Aktakuzës nuk është rregullar nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata në dispozitivin e Aktgjykimit ka bërë përshkrimin faktik si nën pikën I, II, III, IV, V, VI dhe VII të veprave penale si dhe rikualifikimin për veprën penale nga pika V e dispozitivit të Aktakuzës për shkak se gjatë administrimit të provave trupi gjykues ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarve nuk janë vërtetuar elementet për veprën penale që akuzohen si në aktakuzë, me arsyet e theksuar si me lart, dhe se korigjim dhe plotësim në përshkrimin faktik të pikave të Aktgjykimit është bërë në përmbajtjen e fakteve dhe rrethanave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat përbejnë elementet e veprës penale, përshkrimi i fakteve dhe i rrethanave që nënkupton përshkrimin faktik të veprës, që në dispozitiv të Aktgjykimit pas administrimit të provave janë bërë plotësime në përshkrim faktik i nevojshëm në raport me veprat penale dhe nuk është bërë marrja mekanike e plotë e tekstit të Aktakuzës, kjo duke pasur mbështetje edhe në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale faqe 848, në komentim të nenit 365 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, ku citohet “Edhe pse sa i përket përshkrimit faktik të veprës duhet të ekzistojë identiteti ndërmjet aktakuzës dhe aktgjykimit, kjo nuk do të thotë se aktgjykimi duhet ta marrë në mënyrë mekanike dhe tekstualisht tekstin nga aktakuza”, kjo i referohet përshkrimit faktik duke mos cenuar në asnjë mënyrë identitetin objektiv pasi që është përcaktuar kualifikimi ligjor për veprën penale me të cilën akuzohen të akuzuarit dhe atë subjektiv pasi që në dispozitiv të aktakuzës është i vërtetuar identiteti i palës së akuzuar.

IX. Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit në raport me të akuzuarin J.S

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të akuzuarin J.S, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata si rrethanë lehtësuese vlerësoj faktin se palët e dëmtuara tani më janë kompenzuar, faktin se i akuzuari nuk dyshohet për vepra të tjera penale sipas të dhënave në aktakuzë, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata gjeti shkallën e lart të dashjes së të akuzuarit në kryerjen e veprave penale mbi bazën e fakteve dhe arsyet e cekura si më lart në këtë Aktgjykim, shkallën e dëmit të shkaktuar palëve të dëmtuara, mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjykata të akuzuarit J.S i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

X. Kërkesa pasurore juridike dhe kthimi i pasaportës për të akuzuarin J.S

Gjykata si në Aktgjykim ka vendosur që të akuzuarit J.S pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi t'i kthej Pasaportën e Britanisë së Madhe me nr.099167055, pasi që Gjykata ka vlerësuar se nuk ka bazë për konfiskimin e përhershëm të saj apo ndonjë rrethanë tjetër për konfiskimin e saj pasi që ndaj të akuzuarit J.S nuk është caktuar ndonjë masë për sigurimin e tij gjatë procedurës penale apo rrethana të tjera në raport me të akuzuarin J.S pasi që i njëjti në çdo kohë i është përgjigjur ftesave të Gjykatës për seancat e shqyrtimit gjyqësor.

Sa i përketë kërkesës pasurore juridike nga S. B PLC me seli në Londër, Gjykata të njëjtën e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil për realizimin e ndonjë kërkesë eventuale pasurore juridike, këtë Gjykata e ka bërë bazuar në nenin 463 të KPP-së, duke pasur parasysh edhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit EN.nr.02/2017 i dt.30.11.2017.

Sa i përketë kërkesës pasurore juridike nga B. K. T., Gjykata bazuar në parashtrësën të cilën e kanë dorëzuar në Gjykatë me dt.04.06.2021, të njëjtit kanë deklaruar se nuk parashtrojnë kërkesë pasurore juridike dhe se borxhi është realizuar në tërësi në procedurën e falimentimit e që këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar edhe nga Fletëpagesa me nr.00003796 e dt.08.05.2020. Po ashtu përfaqësuesi i B. E. në seancën e dt.09.06.2021 e ka njoftuar Gjykatën se nuk parashtrojnë kërkesë pasurore juridike dhe se borxhi është realizuar në tërësi e që këtë fakt Gjykata e ka vërtetuar edhe nga Fletëpagesa me nr.00003152 e dt.13.05.2020.

Nga arsyet e cekura si më lart u vendos si në këtë Aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.128/2015 dt.15.04.2022

Procesmbajtësi
Endrit Hajrizaj

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Bekim Veliqi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për Gjykatën.